



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3230/11 prot.,

Datë 13.01.2025

V E N D I M

Nr. 50/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.01.2025 u shqyrtua ankesa me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “G.A.C” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-04448-05-13-2024, me objekt: “*Rehabilitimi i ndriçimit të akseve rrugore në qytetin e Durrësit*” me fond limit 24.859.914 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 05.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Vazhdim i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës së operatorit ekonomik “G.A.C” SHPK.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Durrës.
Adresa: Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës.

Ankimues: Operatori Ekonomik “G.A.C” SHPK me NIPT: L61619031A.
Adresa: Rruga “Him Kolli”, pallati i ri 2T, kati i parë, Tiranë.

Baza Ligjore: Nenet 30, 115, 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”; Neni 4 i

Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 14.05.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-04448-05-13-2024, me objekt: “Rehabilitimi i ndriçimit të akseve rrugore në qytetin e Durrësit” me fond limit 24,859,914 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 05.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 28.06.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nga ku rezulton për vlerat pa TVSH si më poshtë:

1.	BOE “K.M.K” SHPK & “Caushi M” SHPK	16.984.700 lekë, skualifikuar
2.	“ASI-2A CO” SHPK	18,678,850 lekë, skualifikuar
3.	“T&XH” SHPK	18,953,550 lekë, skualifikuar
4.	“G.A.C” SHPK	19.639.471 lekë, skualifikuar
5.	“2Z KONSTRUKSION” SHPK	19.932.300 lekë, skualifikuar

- | | | |
|----|--|--------------------------------------|
| 6. | <i>BOE "HTM" SHPK & "AL-ASFALT" SHPK</i> | <i>20.254.650 lekë, skualifikuar</i> |
| 7. | <i>BOE "B93 II" & "B 93" & "BEQIRI" SHPK</i> | <i>20.581.750 lekë, skualifikuar</i> |

II.4. Në datë 01.07.2024 autoriteti kontraktor ka kryer publikimin e Njoftimit të Anulimit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE).

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 03.07.2024 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dhe autoritetit kontraktor është protokolluar ankesa me numër elektronik A/2024/4284, datë 03.07.2024, dhe me nr. 1794/2024 prot., datë 02.07.2024 e operatorit ekonomik "G.A.C" SHPK, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1794/2 prot., datë 04.07.2024, janë publikuar arsyet e skualifikimit për të cilat operatori ekonomik "G.A.C" SHPK ngre pretendime.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 7.07.2024 operatori ekonomik "2Z KONSTRUKSION" SHPK i interesuar në këtë procedurë prokurimi, ka dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, i ndryshuar, në sistemin e ankesave elektronike protokolluar me tonën me nr. 1794/4 prot., datë 08.07.2024 duke pretenduar si në vijim:

"... Së pari,

Lidhur me vlerësimin e procedurës së prokurimit nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, gjykojmë se vlerësimi për operatorin ekonomik "2Z Konstruksion" është i padrejtë. Së dyti,

Në lidhje me vlerësimin për operatorin ekonomik "G.A.C" SHPK me NIPT L61613031A, gjykojmë se vendimi i KVO-së është i drejtë për skualifikimin e tij për arsye se "formularit të vet deklarimit të subjektit "Shansi Invest" u konstatua se e ka plotësuar në mënyrë të gabuar këtë formular. Konkretisht të Pjesa II "Shkaqet e përjashtimit", paragrafi B "deklarata", pika 6 duke e lënë të pa plotësuar". Gjithashtu nëse operatori ekonomik "G.A.C" SHPK me Nipt L61619031A, ka marrë mbështetje me staf teknik siç kërkohet në pikën 2.3.4 të kriterëve të kualifikimit, duhet të ketë të plotësuar deklaratën në pikën D për angazhimin e stafit teknik në punë të tjera publike.

Lidhur me vlerësimin e publikuar nga komisioni i vlerësimit të ofertave, gjykojmë se vlerësimi i OE 2Z KONSTRUKSION është i padrejtë.

Si përfundim, Kërkojmë:

- 1. Rivlerësimin e procedurës së prokurimit.*
- 2. Skualifikimin e OE "G.A.C" SHPK*
- 3. Vazhdimin e procedurës ligjore duke shpallur të kualifikuar OE 2Z KONSTRUKSION shpk për këtë procedurë prokurimi,"*

II.8. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 07.07.2024 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4305 dhe me nr. 1852 protokoli datë 08.07.2024 e operatorit ekonomik “ASI-2A CO” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.9. Në datën 07.07.2024 operatori ekonomik “ASI-2A” SHPK ka dërguar po të njëjtën ankesë të dërguar nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike protokolluar me tonën me nr. 1852/2 prot., datë 09.07.2024.

II.10. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1852/3 prot., datë 09.07.2024, janë publikuar arsyet e skualifikimit për të cilat operatori ekonomik “ASI-2A CO” SHPK ngre pretendime.

II.11. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 08.07.2024 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4308 dhe me nr. 1859 protokoli datë 08.07.2024 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “K.M.K” SHPK & “Çaushi M” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.12. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1859/2 prot., datë 09.07.2024, janë publikuar arsyet e skualifikimit për të cilat bashkimi i operatorëve ekonomikë “K.M.K” SHPK & “Çaushi M” SHPK ngre pretendime.

II.13. Me shkresën nr. 3326/8 prot, datë 17.07.2024 protokolluar me tonën me nr. 1794/5 prot., datë 22.07.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesave të paraqitura nga operatori ekonomik “G.A.C” SHPK, operatori ekonomik “ASI-2A CO” SHPK dhe bashkimi i operatorëve ekonomikë “K.M.K” SHPK & “Çaushi M” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se autoriteti kontraktor me vendimin e datës 17.07.2024 ka pranuar plotësisht ankesat, si më poshtë vijon:

“[...]VENDOSI:

1. *Pranimin e ankesës së OE: “G.A.C” SHPK me NIPT L61619031A, për kontratën me numër të referencës Nr. REF-04448-05-13-2024, me objekt: “Rehabilitimi i ndriçimit të akseve rrugore në qytetin e Durrësit”.*

2. *Pranimin e ankesës së OE: “ASI-2A CO” shpk me NIPT K53002402C, për kontratën me numër të referencës Nr. REF-04448-05-13-2024, me objekt: “Rehabilitim i ndriçimit të akseve rrugore në qytetin e Durrësit”.*
3. *Pranimin e ankesës së BOE: “K.M.K” Shpk me NIPT: L78223801E dhe “Çaushi M” Shpk me NIPT L88419801O, për kontratën me numër të referencës Nr. REF-04448-05-13-2024. Me objekt: “Rehabilitim i ndriçimit të akseve rrugore në qytetin e Durrësit”.[...]*

II.14. Në datën 22.07.2024 Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.941/2024 si vijon:

1. *Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga “G.A.C” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-04448-05-13-2024, me objekt: “Rehabilitimi i ndriçimit të akseve rrugore në qytetin e Durrësit” me fond limit 24,859,914 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 05.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.*
2. *Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga “ASI-2A CO” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-04448-05-13-2024, me objekt: “Rehabilitimi i ndriçimit të akseve rrugore në qytetin e Durrësit” me fond limit 24,859,914 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 05.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.*
3. *Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “K.M.K” SHPK & “Çaushi M” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-04448-05-13-2024, me objekt: “Rehabilitimi i ndriçimit të akseve rrugore në qytetin e Durrësit” me fond limit 24,859,914 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 05.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.*
4. *Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.*
5. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga “G.A.C” SHPK.*
6. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga “ASI-2A CO” SHPK.*
7. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “K.M.K” SHPK & “Çaushi M” SHPK.*
8. *Kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.15. Në datën 28.10.2024 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nga ku rezultojnë operatorët ekonomikë ankimues është skualifikuar për arsye të mëposhtme:

Operatori ekonomik “G.A.C” shpk, paraqiti dokumentacionin e mësipërm në datën 09.10.2024, dorëzuar në Bashkinë Durrës me nr. regjistri 8546, datë 09.10.2024, dokumentacion i cili, sipas procesverbalit të inventarizimit, ka parregullsi, si edhe devijime dhe mospërputhje në vetëdeklarimet e tij sipas shtojces nr. 7 dhe nr. 8, me konkretisht:

- Tek dokumentet standarde të tenderit sipas shtojcës nr.7 “kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit” ku citohet se: “Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, vetë deklarimi sipas shtojcës nr.8 do të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.”.

Referuar dokumentacionit të paraqitur në dosjen fizike, konstatohet se: - Subjekti “Shansi Invest”shpk nuk ka paraqitur dokumenta provuese, të shtojcës 8, për kapitullin “Kritere të përgjithshme të përzgjedhjes së kualifikimit”, konkretisht pikat nga “b” deri tek “i”

- Gjithashtu sipas kriterëve të vecanta të kualifikimit “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.5 thuhet se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/kualifikuar” dhe sipas DST kërkohej 15(pesëmbëdhjetë elektrikista). Për një pjesë të kapacitetit teknik operatori ekonomik “G.A.C”shpk ka kërkuar të mbështetet në kapacitetet teknike të subjektit “Shansi Invest”shpk, duke nënshkruar një kontratë angazhimi në datën 05.06.2024, dhe të vetëdeklaruar në shtojcën 8 të secilit subjekt të stafit teknik. Sipas kontratës së angazhimit operatori ekonomik G.A.C do të mbështetej tek subjekti Shansi Invest”shpk me 12 persona me profesion elektrikist.

Pas verifikimit të dokumentacionit provues për këta punonjës u konstatua se nuk kishte dokument provues të kualifikimit të tyre si elektrikista. Ndërsa vetë operatori ekonomik “G.A.C.” shpk do të kishte tre punonjës elektrikist. Pas verifikimit të dokumentacionit provues për këta tre punonjës u konstatua që ky dokumentacion kishte parregullsi, mos përputhje duke mos vërtetuar profesionin e tyre si elektrikista.

Konkretisht punonjëset E.K dhe Xh.O e kanë kontratën e punës si nëpunëse finance, ndërsa L.H e ka kontratën e punës si punonjëse shërbimi në zyrë dhe nuk kanë certifikatë provuese kualifikimi si elektrikiste.

Në DST pjesë e procedurës së tenderit janë kërkuar 2 teknik elektroteknik. Sipas dokumentave provuese të sjella nga operatori ekonomik “G.A.C”shpk për L. D nuk ka dëshmi kualifikimi për teknik elektroteknik, por ka diplomë për Ing.Informatik Ekonomike.

Gjithashtu sipas DST janë kërkuar gjithashtu 3 drejtues mjeti. Operatori ekonomik “G.A.C”shpk nuk ka paraqitur dokumentacion provues për një drejtues mjeti dhe konkretisht për B. A.

Ndodhur në kushtet e dokumenteve të pa sakta sipas formularit të vetëdeklarimit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranon si të parregullt dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “G.A.C.”shpk, me vlerë të ofertës 19.639.471 lekë, duke e skualifikuar këtë ofertues.

II.16. Në datën 30.10.2024 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin e anulimit të procedurës së prokurimit.

II.17. Në datën 05.11.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4746 dhe nr. 3230/2024 protokolli, datë 05.11.2024 e operatorit ekonomik “G.A.C” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e

ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “G.A.C” SHPK si dhe ngrihen pretendime për zhvillimin dhe anulimin e procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.18. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr.3230/2 prot., datë 05.11.2024, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “G.A.C” SHPK, kundërshton me anë të ankesës me nr. 3230 prot. Konkretisht pretendohet si vijon:

“[...] Dy arsyet e skualifikimit të ofertës tonë, herën e anullimit të parë, janë:

- Nga verifikimi i formularit të vet deklarimit të subjektit “Shansi Invest” u konstatua se e ka plotësuar në mënyrë të gabuar këtë formular. Konkretisht te Pjesa II “Shkaqet e përjashtimit”, paragrafi B “Deklarata”, pika 6 duke e lënë të pa plotësuar.

- Tek pjesa e tretë e shtojcës 8, “Kriteret e përzgjedhjes së kualifikimit”, paragrafi D “Deklaratë mbi mos angazhimin e kapaciteteve teknike në kontratat e tjera” te kriteret e vecanta të kualifikimit, “Shansi Invest” shpk stafin teknik mbështetës në mbështetjë të subjektit “GAC” shpk nuk e deklaroi nëse e ka të angazhuar apo jo. [...].

Në pikën 2.16 të DT, AK Baslakia Durrës, nuk ka plotësuar opsionin PO, ku të specifikonte detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja, por ka plotësuar opsionin JO.

Në këto kushte, mbështetja në kapacitete të tjera, lejohet për të gjitha kushtet për kualifikim. [...]

Në rastin konkret ofertues është shoqëria G.A.C SHPK dhe jo shoqëria “Sh.I.” Shpk. Pra në këtë procedurë prokurimi “G.A.C” Shpk është mbështetur në kapacitetet e shoqërisë “Sh.I.” Shpk, sikurse ligji e parashikon, si dhe nuk ka marrë pjesë si BOE.

Në këto kushte, shoqëria mbështetëse nuk ka se si të plotësojë pjesën e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit që, nëse po oferton ofertë të pavarur apo është konsultuar, sepse nuk është ofertuese në tender.

Ofertues në këtë procedurë është shoqëria jonë, e cila e ka plotësuar këtë pjesë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, duke deklaruar që ka dorëzuar ofertë të pavarur, pa u konsultuar dhe pa bërë marrëveshje apo rënë dakord me asnjë konkurent tjetër. [...]

Lidhur me arsyet e dhëna për anulimin e dytë të kësaj procedure, sqarojmë teknikisht dhe ligjërisht:

Pas bërjes së kësaj ankese, në SPE nga ana e Bashkisë Durrës u reflektua ku pasi shqyrtoi ankesën e bërë, pra KSHA-ja që shqyrtoi ankesën tonë, vendosi që oferta e shoqërisë tonë të kualifikohet.

Pra vetë Bashkia e pranoi që kishte dhënë një vendim anti ligjor mbi vlerësimin në rastin e mbështetjes në kapacitete të tjera, për të cilën reflektoi dhe kualifikoi ofertën tonë, si ofertë e suksesshme.

Për këtë rast është në dijeni KPP, sepse ka kthyer përgjigje, por ndërkohë në kundërshtim me LPP, KPP nuk shqyrtoi pretendimet tona të tjera, lidhur me ofertat e tjera.

Pas një periudhe shumë të gjatë kohore, ku KPP duhet të verifikojë në AK për datat konkrete, nga tri shoqëri që ishim të kualifikuara, dy të parat u skualifikuan dhe ngeli e vetme vetëm oferta e shoqërisë tonë.

Ndërkohë në datë 28.10.2024 në SPE na vjen njoftim për skualifikim, sipas parashtrimeve të mësipërme. Më datë 30.10.2024 AK publikon formularin e anulimit të kësaj procedure për herë të dytë.

- Kërkojmë nga KPP, të sqarojë të gjithë situatën me data konkrete kur janë informuar të dy shoqëritë e tjera, si dhe përse janë skualifikuar, çfarë date e kanë dorëzuar dokumentacionin dhe sa ditë i është dashur AK të kthejë përgjigje, pra çfarë është bërë nga data e dorëzimit të ankesës së parë deri më datë 28.10.2024.
- Kërkojmë në bazë të ligjit për informimin publik, të na vihen në dispozicion emrat e anëtarëve dhe personave përkatës të cilët kanë dhënë arsyet e anulimit të herës së dytë.
- Kërkojmë nga KPP të na vërë në dispozicion dhe të na sqarojë profesionet përkatëse arsimore të anëtarëve dhe personave përkatës të cilët kanë dhënë arsyet e anulimit të herës së dytë.
- Kërkojmë nga KPP të na vërë në dispozicion dhe të na sqarojë a kanë kualifikime në fushën e prokurimit publik, së bashku me certifikimet përkatëse, të gjithë anëtarëve dhe personave përkatës të cilët kanë dhënë arsyet e anulimit të herës së dytë, sikurse ndryshimet e LPP parashikojnë. Në rast se po, çfarë niveli janë të secilës prej tyre.
- Rasti i mosdhënies së këtij informacioni, në kundërshtim me ligjin për informimin publik, do të konsiderohet, referuar Ligjit, si fshehje dhe mosdhënie e informacionit.
- KPP të na sqarojë me data referuese, çfarë ka bërë AK nga data 5 qershor 2024 deri më datë 28 tetor 2024 kur ka publikuar anulimin për herë të dytë.

Le të sqarojmë konkretisht secilën prej arsyeve të dhëna herën e dytë për anulim.

1. Referuar shtojcës 7 kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit citohet se: Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, vetë deklarimi sipas shtojcës 8 do të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Referuar kësaj arsyeje të dhënë në arsyet e skualifikimit për anulimin e herës së dytë, ju bëjmë me dije se, subjekti mbështetës, ka paraqitur në tender formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Kërkojmë nga KPP verifikimin në SPE, të kësaj arsyeje antiligjore të dhënë nga personat përgjegjës të AK që kanë bërë anulimin e tenderit të herës së dytë.

Gjithashtu, referuar arsyeve të dhëna herën e parë, AK ka pranuar që formulari i vetëdeklarimit të paraqitur në tender nga subjekti mbështetës nuk e ka plotësuar atë konform ligjit, duke na skualifikuar.

Pas ankesës së herës së parë, na kualifikojnë, pra që vetë AK ka pranuar që është paraqitur. Ndërkohë, këtë herë të dytë anulimi, na japin si arsye skualifikimi që mbështetës nuk ka paraqitur në tender këtë formular, pretendim ky absurd, dhe i pavërtetë, pasi në tender është paraqitur si formulari i vetëdeklarimit nga ana jonë, ashtu edhe ajo e subjektit mbështetës.

Në këto kushte, në një vlerësim të tillë kontradiktor, ku njëherë të skualifikojnë që formulari i subjektit mbështetës nuk është plotësuar saktë, ndërkohë herën e dytë të skualifikojnë që nuk e ka paraqitur fare, kërkojmë nga KPP verifikimin e hollësishëm të këtij fakti, sipas dokumentacionit në SPE.

Kërkojmë nga KPP të na informojë dhe verifikojë se kush ka qenë me profesion jurist personi/at që kanë dhënë herën e dytë arsyet e skualifikimit dhe të anulimit për herë të dytë, duke qenë se kanë hyrë dhe kanë bërë interpretime edhe në shumë detaje ligjore. Kjo kërkesë bazohet në ligjin për të drejtën e informimit publik.

Në këto kushte, arsyeja e parë e dhënë për skualifikim për anulimin e dytë është totalisht antiligjore, ku formulari i subjektit mbështetës, gjendet i ngarkuar në SPE.

Gjithashtu, për këtë pikë, kërkojmë nga KPP të mundësojë që të bëhet ballafaqimi i palëve, pra i përfaqësuesit tonë dhe i anëtarëve të komisionit të AK-së që kanë dhënë arsyen e dytë për skualifikim dhe anulim për herë të dytë.

2.Referuar dokumentacionit të paraqitur në dosjen fizike, konstatohet se, subjekti mbështetës “Sh.I. nuk ka paraqitur dokumenta provuese të shtojcës 8 për kapitullin kritere të përgjithshme të përzgjedhjes së kualifikimit.

Në lidhje me këtë pretendim, sqarojmë se, nga ana e shoqërisë sonë është paraqitur në tender, në fazën fillestare i gjithë informacioni dhe dokumentacioni provues, përfshirë edhe dokumentacionin e subjektit mbështetës.

Pra, çdo dokument është paraqitur on line në SPE, për të cilën AK nuk ka ngritur asnjë pretendim.

Pra, nuk është dokumentacion që është dorëzuar vetëm bazuar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, por është paraqitur në tender i gjithi, në SPE.

Në rast se do të kishin pretendime, AK duhej të kishte dhënë si arsye skualifikimi që herën e parë që u anulua ky tender dhe oferta jonë u skualifikua.

Pra është një pretendim i dhënë pas tejkalimit të çdo afati të mundshëm ligjor kohor. [...].

Në rast se do të kishte pretendime, AK duhej të na kishte kërkuar paraqitjen e dokumentacionit konkret për subjektin mbështetës, gjë e cila nuk ka ndodhur. [...].

Ligjvënësi ka parashikuar dorëzimin dhe plotësimin nga ofertuesi dhe jo nga subjekti mbështetës. [...].

Me dokumentacion provues, sikurse ligji e parashikon, kemi provuar burimet e nevojshme.

I kemi provuar AK se nuk ekzistojnë shkaqet e skualifikimit, duke dhënë në formularin e subjektit mbështetës të gjitha adresat ku mund të merret informacioni i kërkuar nga AK.

Gjithashtu, kemi plotësuar mbi 50% të kritereve të dhëna në dokumentet e tenderit. [...].

Gjithashtu, duke qenë se ndryshimet e LPP mbase nuk janë reflektuar nga AK, ju sqarojmë me fakte dhe prova se:

Në nenin 22 të ligjit nr.16/2024 për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.162/2020 “Për prokurimi publik”, me ndryshimet e pësuara, parashikohet se:

3. Pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“8. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim.”.

Besojmë se AK përpara se të merrte vendimin për skualifikim për herë të dytë, e ka ditur që ekziston edhe kjo dispozitë ligjore, e cila ka hyrë në fuqi shume kohë përpara hapjes së

tenderit. Besojmë se AK e ka ditur dhe ka pasur njohuri mbi ndryshimet që ka pësuar LPP dhe çfarë parashikojnë, përfshirë edhe IA, pra Inteligjencën Artificiale.

Pra sistemi SPE i verifikon automatikisht kriteret për shoqëritë e regjistruara në regjistrat tregtare Shqiptare.

Për më shumë shikoni çfarë parashikojnë dispozitat sesi kanë ndryshuar të LPP, konkretisht ligji 16/2024.

Gjithashtu në ndryshimet e pësuar në ligj parashikohet se:

Në nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni, sipas shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike, u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.”.

2. Pas pikës 5 shtohen pikat 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 me këtë përmbajtje:

“6. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, krijimi dhe plotësimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit kryhet në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

7. Pavarësisht parashikimeve të pikës 5 të këtij neni, operatorëve ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë nuk u kërkohet të paraqesin dokumente mbështetëse ose prova të tjera dokumentare për atë pjesë të informacionit të deklaruar dhe të gjeneruar automatikisht në Sistemin e Prokurimit Elektronik si pjesë e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga ndërveprimi me sisteme të tjera elektronike.

8. Operatorët ekonomikë mund të përmbushin kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit edhe nëpërmjet dosjes virtuale të operatorit, e krijuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera elektronike për ruajtjen e dokumenteve. Dokumentet e dorëzuara si pjesë e dosjes virtuale të operatorit duhet të jenë të gjeneruara nga sisteme të tjera elektronike ose të noterizuara përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Operatorët ekonomikë janë përgjegjës për përditësimin e të dhënave në mënyrë automatike, për aq sa është e mundur, në dosjen virtuale të operatorit.

9. Për operatorët ekonomikë vendës, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim dhe kriteret e veçanta të kualifikimit për aq sa është e zbatueshme.

10. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor për operatorët ekonomikë të huaj i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor në origjinal ose kopje të noterizuar dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike, të cilat nuk mund të gjenerohen automatikisht nga sistemet e tjera me anë të ndërveprimit. Dokumentet e noterizuara para noterëve publikë të Republikës së Shqipërisë dorëzohen online në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni sipas pikës 5 u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

11. Autoriteti ose enti kontraktor do të përdorë sistemin e-Certis për të marrë informacion për llojet dhe format e provave të përmendura në këtë nen dhe për autoritetet kompetente, që i lëshojnë ato në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.”.

Kërkojmë nga KPP të sqarojë dispozitat e mësipërme të dhëna me “bold” konkretisht pika 5, 7, 9, 10, 11, ku vërtetohet shkelja e rrethit të Ligjit nga AK.

Pra AK i kërkon shpjegime ofertuesit, jo subjektit mbështetës.

Pra pika 7 hedh poshtë çdo pretendim antiligjor të AK. Pra çdo gjë verifikohet nga sistemi. Në rast se sistemi nuk ndërvepron, kërkojmë nga KPP të na konfirmojnë një rast të tillë. Mosdhënia e përgjigjes për këtë pikë do të sjellë nga KPP si pasojë, pranimin e saj në heshtje që sistemi SPE nuk ndërvepron si dhe do merret si e mirëqenë që KPP e ka pranuar në heshtje këtë gjë.

Në nenin 35 të ndryshimeve ligjore, parashikohet se:

3. Pas pikës 8 shtohet pika 9 me këtë përmbajtje:

“9. Sistemi i prokurimit elektronik njofton operatorët ekonomikë në mënyrë automatike për datën e fillimit dhe të përfundimit të afateve të ankimit.”.

Ndërkohë nuk ka ardhur asnjë njoftim se kur fillojnë dhe kur mbarojnë afatet e ankimit.

KPP të sqarojë mirë këtë fakt përse nuk ka ardhur nga SPE se kur fillon dhe kur mbaron data e ankimit.

Në këto kushte, lidhur me këtë arsye skualifikimi, në kushtet kur AK nuk ka detajuar dhe nuk na ka kërkuar se çfarë dokumentash konkretë kërkon për subjektin mbështetës, ndërkohë që në formularin e vetëdeklarimit subjekti mbështetës ka dhënë bazën e të dhënave me adresat përkatëse se ku AK i gjen këto informacione, vendimi i marrë për skualifikim për herën e dytë, nuk gjendet i bazuar në ligj dhe prova. Për më tepër kur Ligji dhe RRPP me ndryshimet e fundit parashikon se këto të dhëna gjenerohen automatikisht nga SPE, konkretisht kriteret e përgjithshme për kualifikim.

3. Gjithashtu, në DST kërkojnë 15 elektrikistë. Për një pjesë të kapacitetit, operatori “G.A.C” SHPK ka kërkuar të mbështetet në kapacitetet teknike të subjektit “Sh.I.” SHPK, duke

nënshkruar një kontratë angazhimi dhe të vetëdeklaruar në shtojcën nr. 8. Sipas kontratës së angazhimit shoqëria “G.A.C” SHPK do të mbështetë për 12 persona, me profesion elektrikistë. Pas verifikimit të dokumentacionit provues për këta punonjës u konstatua se nuk kishte dokument provues të kualifikimit të tyre si elektrikista.

Në lidhje me këtë pretendim, kërkoj më nga KPP të verifikojë dokumentacionin e paraqitur në tender, pra në SPE, sepse nga ana jonë është dorëzuar i gjithë dokumentacioni që në fillim, NË DATEN E HAPJES SË OFERTAVE. [...]

Ju sqarojmë se, numri prej 15 personash tejkalohet shumëfish, pasi dhe nga ana jonë është paraqitur një numër shumë i lartë elektrikistash, ndërkohë që nga subjekti mbështetës na janë vënë në dispozicion edhe 12 të tillë të tjerë. [...]

Kërkojmë nga KPP, të verifikojë kontratën e angazhimit, si dhe formularin përmbledhës të vetdeklarimit të subjektit mbështetës, nga ku do të provoni dhe vërtetoni se për të 12 personat janë hedhur në tender në sistemin SPE kontratat e punës që këta punonjës kanë me subjektin mbështetës, listpagesat e subjektit mbështetës ku provohet se janë të punësuar pranë kësaj shoqërie, si dhe në fund të çdo kontrate punësimi, për të 12 personat gjendet dëshmitë e sigurimit dhe kualifikimit si elektrikista. [...]

4. Lidhur po me kriterin për 15 elektrikista, AK sqaron se, “G.A.C” SHPK do të kishte tre punonjës elektrikistë. Pas verifikimit të dokumentacionit, për këta tre punonjës u konstatua se ky dokumentacion kishte parregullsi, mos përputhje duke mos vërtetuar profesionin e tyre si elektrikista.

Në lidhje me këtë pretendim të AK, sqarojmë se, shoqëria jonë ka hedhur në tender dokumentacionin e plotë për Z. B.A i certifikuar edhe si elektrikist, Z.K.A. i certifikuar edhe si elektrikist, Z. A.M i certifikuar edhe si elektrikist, Znj. E.K. e certifikuar edhe si elektriciste, Znj. Xh.O., e certifikuar edhe si elektriciste, Znj. L.H., e certifikuar edhe si elektriciste, Z.A.A. i certifikuar edhe si elektrikist, Z.K.S. i certifikuar edhe si elektrikist.

Pra, nga ana jonë është paraqitur dokumentacion në tender për 8 persona, të kualifikuar dhe të certifikuar si elektrikistë, ndërkohë AK sqaron se janë vetëm 3. [...]

Bashkëlidhur çdo kontratë pune, do të gjeni edhe trajnimet përkatëse të tyre si elektrikistë apo të hedhura dokumentacionet në sistemin SPE. [...]

5. Po më tej, AK për kriterin për 15 elektrikistë na ka sqaruar se, konkretisht punonjëset Znj. E.K, dhe Znj. Xh. O. E. kanë kontratën e punës si nëpunëse finance, ndërsa Znj. L.H. e ka kontratën e punës si punonjëse shërbimi në zyrë, dhe nuk kanë certifikata provuese kualifikimi si elektrikistë. [...]

Për të dy personat e mësipërm, Znj. E.K. dhe Znj. Xh.O., në kontratat e tyre respektive të paraqitura në tender në sistemin SPE, në nenin 1 të kontratës është rënë dakord që, këta punonjës do të kryejnë detyrën e ekonomistit për marketing dhe tjetra si nëpunëse finance, por pas kësaj fjale është edhe lidhëza /, dhe vazhdon fjalia sipas nevojave profesionale të punës dhe shoqërisë.

Gjithashtu, në fund të kontratave të punësimit, janë edhe certifikimet përkatëse si elektrikistë. E njëjta gjë vlen për analogji edhe për Znj. L. H. ku në nenin 1 përveç punës si punonjëse shërbimi në zyrë, do të jetë edhe sipas nevojave profesionale të punës dhe të shoqërisë. Gjithashtu, në fund të kontratës, gjendet edhe certifikimi si elektrikistë.

Në këto kushte, arsyeja e dhënë është antiligjore, pasi dokumentacioni gjendet i ngarkuar në tender, në origjinal.

6.Në DST janë kërkuar 2 teknikë elektroteknikë. Sipas dokumenteve provuese të sjella, nga operatori ekonomik "G.A.C" SHPK për Znj. L.D. nuk ka dëshmi kualifikimi për teknik elektroteknikë, por ka diplomën për Inxhinier Informatikë Ekonomike.

Lidhur me Znj. L.D. është paraqitur në tender në SPE kontrata e punës, diploma dhe pas diplomës do të gjeni certifikimin si teknik i lartë elektroteknik. [...].

Pra, pretendimi i AK nuk qëndron, pasi dokumentacioni, dëshmi kualifikimi sikurse AK pretendon, është hedhur në tender edhe certifikimi si teknik i lartë elektroteknik, pasi është Inxhinier.

7.Gjithashtu, në DST janë kërkuar tre drejtues mjeti. Operatori ekonomik "G.A.C" SHPK nuk ka paraqitur dokumentacion provues për një drejtues mjeti dhe konkretisht për Z.B.A.

Patenta e Z.B.A. është hedhur në tender dhe gjendet në SPE. Faqja e parë është karta e identitetit, faqja e dytë është patenta.

Përveç këtij personi, lejet e drejtimit janë hedhur edhe për shumë të tjerë si Z.K.S., Z.A.A. si dhe 1 nga subjekti mbështetës. Pavarësisht kësaj, për të tre personat e shoqërisë tonë, janë hedhur në tender dokumentacionet përkatëse provuese.

8. Ndodhur në kushtet e dokumenteve të pasakta, sipas formularit të vetëdeklarimit.

Nuk e kuptojmë se çfarë ka dashur të thotë personi që ka shqyrtuar dokumentacionin, sepse të gjitha sa janë përcaktuar në formularët përmbledhës të vetëdeklarimit, janë paraqitur në tender në sistemin online SPE, që në datën e hapjes së ofertave, pra nuk ka qenë ndonjë rrethanë që nuk ka qenë e paditur më parë nga AK.

9.KVO pas verifikimit ka pranuar si të parregullt dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik "G.A.C" SHPK, duke e skualifikuar këtë ofertues.

Se çfarë kanë gjetur për arsye skualifikimi, mbetet në dorë të KPP verifikimi i kësaj ankese, pasi nga AK janë shkelur çdo dispozitë e mundshme ligjore dhe nënligjore, si dhe nga personat që kanë bërë anulimin e dytë, konstatohet skualifikim në kundërshtim me LPP-në.

Një tjetër shkelje shumë e rëndë ka të bëjë me faktin se:

Te pika 9, AK ka sqaruar se KVO pas verifikimit ka vendosur skualifikimin e ofertës tonë.

- AK në vendimin e anulimit për herën e dytë na sqaron që KVO na ka skualifikuar. Pas ankesës së parë është ngritur një KSHA, të paktën 3 persona të tjerë, se kështu parashikon ligji, ndërkohë që KVO na ka skualifikuar.
- KVO e ka pasur në dispozicion këtë dokumentacion që në datën e hapjes së procedurës, sepse ka qenë i gjithi i ngarkuar në SPE, ndërkohë në këtë vendim për herë të dytë për anulim na thonë për dokumentacionin e paraqitur. Përse janë mbajtur dy standarde vlerësimi, ku herën e parë nuk është parashtruar asnjë fakt i tillë?
- Sa herë kanë bërë vlerësime, kanë nxjerrë arsye të ndryshme.
- Kërkojmë në bazë të ligjit për informimin publik, emrat e anëtarëve të KVO-së, emrat e anëtarëve të KSHA 1, emrat e anëtarëve të KSHA 2 që do të shqyrtojnë këtë ankesë, si dhe emrat e personave dhe profesionet se kush ka bërë anulimin e dytë.

- Kërkojmë nga KPP të marrë konfirmimin në APP përse ka vlerësuar KVO, ndërkohë që ka patur ankesa dhe duhej të ishin vlerësuar nga KSHA 1.
- Kërkojmë marrjen e të gjithë dosjes për dhe të gjitha procesverbaleve të mbajtura për vlerësim nga AK, si dhe verifikimin e numrave të protokollit të tyre.
- Kërkojmë për sa kemi parashtruar në këtë ankesë, verifikimin e dokumentacionit të paraqitur në tender nga ana jonë, në SPE, apo edhe dokumentacionin fizik, dhe të sqarojë përse nuk është dhënë si arsye që herën e parë, ndërkohë që dokumentacioni ishte i ngarkuar në sistemin SPE. [...].”

II.19. Në datën 26.11.2024, në Komisionin e Prokurimit Publik është protokolluar me nr. 3230/4, shkresa e autoritetit kontraktor me nr. 3326/21 prot., datë 25.11.2024 me objekt: “Dërgohet vendimi mbi shqyrtimin e ankesave për procedurën me objekt-ankimimi: “Rehabilitimi i ndriçimit të akseve rrugore në qytetin e Durrësit””, bashkëngjitur Vendimi i KSHA-së “Mbi ankesën e operatorit ekonomik “G.A.C” SHPK” për procedurën me objekt: “Rehabilitimi i ndriçimit të akseve rrugore në qytetin e Durrësit”. Referuar Vendimit të KSHA-së rezulton, se autoriteti kontraktor e ka pranuar pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “G.A.C” SHPK. Konkretisht KSHA është shprehur si vijon:

“[...]

Ofertuesi në ankesë pretendon:

1. Referuar shtojcës 7 kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit citohet se: Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, vetëdeklarimi sipas shtojcës 8 do të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Referuar kësaj arsyeje të dhënë në arsyet e skualifikimit për anulimin e herës së dytë, ju bëjmë me dije se, subjekti mbështetës, ka paraqitur në tender formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Kërkojmë nga KPP verifikimin në SPE, të kësaj arsyeje antiligjore të dhënë nga personat përgjegjës të AK që kanë bërë anulimin e tenderit të herës së dytë.

Gjithashtu, referuar arsyeve të dhëna herën e parë, AK ka pranuar që formulari i vetëdeklarimit të paraqitur në tender nga stibjekti mbështetës nuk e ka plotësuar atë konform ligjit, duke na skualifikuar.

Pas ankesës së herës së parë, na kualifikojnë, pra që vetë AK ka pranuar që është paraqitur. Ndërkohë, këtë herë të dytë anulimi, na japin si arsye skualifikimi që mbështetës nuk ka paraqitur në tender këtë formular, pretendim ky absurd, dhe i pavërtetë, pasi në tender është paraqitur si formulari i vetëdeklarimit nga ana jonë, ashtu edhe ajo e subjektit mbështetës.

Në këto kushte, në një vlerësim të tillë kontradiktor, ku njëherë të skualifikojnë që formulari i subjektit mbështetës nuk është plotësuar saktë, ndërkohë herën e dytë të skualifikojnë që nuk e ka paraqitur fare, kërkojmë nga KPP verifikimin e hollësishëm të këtij fakti, sipas dokumentacionit në SPE.

Kërkojmë nga KPP të na informojë dhe verifikojë se kush ka qenë me profesion jurist personi/at që kanë dhënë herën e dytë arsyet e skualifikimit dhe të anulimit për herë të dytë, duke qenë se kanë hyrë dhe kanë bërë interpretime edhe në shumë detaje ligjore. Kjo kërkesë bazohet në ligjin për të drejtën e informimit publik.

Në këto kushte, arsyeja e parë e dhënë për skualifikim për anulimin e dytë është totalisht antiligjore, ku formulari i subjektit mbështetës, gjendet i ngarkuar në SPE.

Gjithashtu, për këtë pikë, kërkojmë nga KPP të mundësojë që të bëhet ballafaqimi i palëve, pra i përfaqësuesit tonë dhe anëtarëve të komisionit të AK-së që kanë dhënë arsyen e dytë për skualifikim dhe anulim për herë të dytë.

Referuar dokumentacionit të paraqitur në dosjen fizike, konstatohet se, subjekti mbështetës “Sh.I. nuk ka paraqitur dokumenta provuese të shtojcës 8 për kapitullin kritere të përgjithshme të përzgjedhjes së kualifikimit.

Në lidhje me këtë pretendim, sqarojmë se, nga ana e shoqërisë tonë është paraqitur në tender, në fazën fillestare i gjithë informacioni dhe dokumentacioni provues, përfshirë edhe dokumentacionin e subjektit mbështetës.

Pra, çdo dokument është paraqitur on line në SPE, për të cilën AK nuk ka ngritur asnjë pretendim.

Pra, nuk është dokumentacion që është dorëzuar vetëm bazuar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, por është paraqitur në tender i gjithi, në SPE.

Në rast se do të kishin pretendime, AK duhej të kishte dhënë si arsye skualifikimi që herën e parë që u anulua ky tender dhe oferta jonë u skualifikua.

Pra është një pretendim i dhënë pas tejkalimit të çdo afati të mundshëm ligjor kohor.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës arsyeton:

Në lidhje me këtë pretendim të ofertuesit se është paraqitur në tender, që në fazën fillestare i gjithë informacioni dhe dokumentacioni provues, përfshirë edhe dokumentacionin e subjektit mbështetës, në këtë rast pretendimi i ofertuesit nuk qëndron pasi neni 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregulave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon: “Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: -ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës; -t’i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme. -t’i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së. Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.”

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar si më poshtë vijon:

“Për ofertuesit G.A.C shpk me NIPT: L61619031A me vlerë të ofertës 19,639,471 [nëntëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një] lekë pa T.V.SH, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kritereve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik, “G.A.C” shpk, ka një kontratë angazhimi mbi mbështetjen në kapacitetet teknike me subjektin “Shansi invest” shpk. - Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të subjektit “Shansi Invest” u konstatua se e ka plotësuar në mënyrë të gabuar këtë formular. Konkretisht tek Pjesa II “Shkaqet e përjashtimit”, paragrafi B “Deklarata”, pika 6 duke e lënë të pa plotësuar. - Tek pjesa e tretë e shtojcës 8, “Kriteret e përzgjedhjes së kualifikimit”, paragrafi D “Deklaratë mbi mos angazhimin e kapaciteteve teknike në kontratat e tjera” te kritereve të veçanta te kualifikimit, “Shansi Invest” shpk stafin

teknik mbështetës në mbështetjë të subjektit “GAC” shpk nuk e deklaroi nëse e ka të angazhuar apo jo. Mbështetur në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, të ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, KVO vendos që ofertuesit “G.A.C” shpk të mos kualifikohet”.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka vlerësuar si më poshtë vijon:

1. Lidhur me ankesën e OE, ankues “G.A.C” shpk me NIPT L61619031A, sqarojmë se objekti i ankesës lidhet me skualifikimin e OE nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për mospërmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në Dokumentat e tenderit, dhe konkretisht për pikat si vijon, duke cilësuar.

Operatori Ekonomik “G.A.C” shpk, ka një kontratë angazhimi mbi mbështetjen në kapacitetet teknike me subjektin “Shansi Invest” shpk.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të subjektit “Shansi Invest” u konstatua se e ka plotësuar në mënyrë të gabuar këtë formular. Konkretisht tek Pjesa II “Shkaqet e përjashtimit”, paragrafi B “Deklarata”, pikë 6 duke e lënë të paplotësuar.

Tek pjesa e tretë e shtojcës 8, “Kriteret e përzgjedhjes së kualifikimit”, paragrafi D “Deklaratë mbi mos angazhimin e kapaciteteve teknike në kontratat e tjera” të kriterëve të vecanta të kualifikimit “Shansi Invest” shpk stafin teknik mbështetës në mbështetjë të subjektit “GAC” shpk nuk e deklaroi nëse e ka të angazhuar apo jo. ...”

Pas vlerësimit të dokumentacionit nga KSHA, konstatohet se:

Në dokumentet e tenderit të kërkuar në këtë procedurë prokurimi, përcaktohet se: Në rast se operatorët ekonomikë ofertues do të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, një formulari veçantë i vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës. [...].

Në nenin 90, pika 7 të VKM-së nr.285, datë 19.5.2021 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’ i ndryshuar, përcaktohet saktë: Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit.

Në këto kushte subjekti “Shansi Invest” SHPK në cilësinë e subjektit mbështetës nuk ka detyrimin ligjor ta plotësojë pikën 6, paragrafi B “Deklarata” të pjesës II, kriteri i cili duhet të plotësohet vetëm nga ofertuesi.

Lidhur me pikën e parë të ankesës KSHA vlerëson se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron dhe ankesa duhet pranuar.

Sa i përket pikës së dytë të ankesës ku citohet nga KVO:

Te pjesa e tretë e shtojcës 8, “Kriteret e përzgjedhjes së kualifikimit”, paragrafi D “Deklaratë mbi mos angazhimin e kapaciteteve teknike në kontratat e tjera” të kriterëve të vecanta të kualifikimit, “Shansi Invest” shpk stafin teknik mbështetës në mbështetjë të subjektit “GAC” shpk nuk e deklaroi nëse e ka të angazhuar apo jo. [...]”, KSHA konstaton se:

Në dokumentet e tenderit autoriteti kontraktor Bashkia Durrës, në shtojcën 7, pika 2 Kriteret e Veçanta, ndër të tjera ka kërkuar edhe:

- 2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- a. Inxhinier Elektrik 1 (një)

Për stafin e sipërcituar të paraqese dokumentacion që vërteton profesionin si: dëshmi profesionale (diploma e inxhinierëve) ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune. Ky kriter

përbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST.

2.3.4. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- a. Inxhinier Gjeodet 1 (një)
- b. Teknik ndërtimi 1 (një)

Për stafin e sipërcituar të disponojë dokumentacion që vërteton profesionin si: diploma e inxhinierëve dhe kontrata pune. Për stafin e sipërcituar të disponojë dokumentacion që vërteton profesionin si: Dëshmi profesionale e teknikut të ndërtimit ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune. Ndërsa për punëtorin të thjeshtë, të disponojë një vetëdeklarim nga shoqëria, ku listohen si punëtorë të thjeshtë

Ky kriter përbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- a. Teknik Ndërtimi 3 (tre)
- b. Elektricitist 15 (pesëmbëdhjetë)
- c. Teknik Elektroteknik 2 (dy)
- d. Manovratorë 1 (një)
- e. Drejtues Mjeti 3 (tre)
- f. Punëtor të thjeshtë 15 (pesëmbëdhjetë)

Për stafin e sipërcituar të disponojë dokumentacion që vërteton profesionin si: dëshmi profesionale të punonjësve ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune. Ndërsa për punëtorë të thjeshtë ndërtimi, të disponojë një vetëdeklarim nga shoqëria, ku listohen si punëtorë të thjeshtë ndërtimi. Ky kriter përbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST.

Nga sa shihet më sipër autoriteti kontraktues në kriteret kualifikuese të përcaktuara përkatësisht në pikat 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5 të shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit nuk ka kërkuar që operatori ekonomik të deklarojë se stafi inxhinierik, stafi i specialistëve, punonjësit e specializuar, nuk duhet të jenë të angazhuar edhe në objekte të tjera. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga shoqëria ankuese "G.A.C" SHPK dhe konkretisht i shtojcës 8 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" të datës 05.06.2024, deklarata e subjektit mbështetës "Shansi Invest" SHPK, për përbushjen e kriterëve kualifikuese të përcaktuara në pikat 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5 të shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit, lidhur me disponimin e stafit, KSHA gjykon se i ka plotësuar kriteret kualifikuese të sipërpërmendura, duke dëshmuar se disponon stafin e kërkuar. Njëkohësisht sqarojmë se operatori ekonomik ofertues "G.A.C" SHPK e ka paraqitur shtojcën 8 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" të plotësuar, duke dëshmuar se disponon stafin e kërkuar nga AK për zbatimin e kësaj kontrate.

Lidhur me pikën edytë të ankesës, KSHA vlerëson se pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron dhe ankesa duhet pranuar.

Duke analizuar vlerësimin e KVO-së dhe pretendimet që ngrihen nga ofertuesi, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës konstaton se KVO duhet të kishte nxjerre pretendimet që në momentin e vlerësimit në SPE për arsyen se ofertuesi nuk i ka ndryshuar dokumenta të vetëdeklarimit,

pra ato dokumenta që ka deklaruar ne formularin e vetedeklarimit po ato dokumenta njëkohësisht i ka ngarkuar ne edhe në SPE, ne keto momente KVO duhet ta kishte bere me dije për mosplotësimin e tyre. Theksojmë se procedura ka vazhduar me ankesën e ofertuesit dhe eshte pranuar nga KSHA duke e kualifikuar ofertuesin njëkohësisht është dhënë dhe vendimi deklarativ nga KPP. Me te drejte ofertuesi ngre pretendimin per dokumentacionin e dorëzuar fizikisht, pasi eshte i njëjti dokumentacion i dorëzuar ne SPE, pra pretendimi i ofertuesit në këtë rast qëndron. Ndërkohë KVO nuk është referuar mbi dokumentacionin e dorëzuar nga ofertuesi ne SPE, por eshte bazuar vetëm tek vetedeklarimi i ofertuesit dhe e ka konsideruar te rregullt.

Pika 4 e nenit 84 “Mbështetja ne kapacitetet e subjekteve të tjera”, i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimi publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit. “Ligjvënësi ka parashikuar se ofertuesi duhet të vërtetojë me dokumentacion provues se për subjektin mbështetës nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikim sipas parashikimeve të nenit 76 te LPP-së, në rastin se ekzistojnë shkaqet për kualifikim autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit që të zëvendësojë subjektin.

- Ofertuesi në ankesë pretendon:

Gjithashtu, duke qenë se ndryshimet e LPP mbase nuk janë reflektuar nga AK, ju sqarojmë me fakte dhe prova se:

Në nenin 22 të ligjit nr.16/2024 për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.162/2020 “Për prokurimi publik”, me ndryshimet e pësuar, parashikohet se:

3. Pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“8. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim.”.

Besojmë se AK përpara se të merrte vendimin për skualifikim për herë të dytë, e ka ditur që ekziston edhe kjo dispozite ligjore, e cila ka hyrë në fuqi shumë kohë përpara hapjes së tenderit. Besojmë se AK e ka ditur dhe ka patur njohuri mbi ndryshimet që ka pësuar LPP dhe çfarë parashikojnë, përfshirë edhe IA, pra Inteligjencën Artificiale.

Pra sistemi SPE i verifikon automatikisht kriteret për shoqëritë e regjistruara ne regjistrat tregtare Shqiptare.

Për me shume shikoni çfarë parashikojnë dispozitat se si kane ndryshuar te LPP, konkretisht ligji 16/2024.

Gjithashtu në ndryshimet e pësuar ne Ligj parashikohet se:

Në nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

- g. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni, sipas shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike, u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.”.

h. Pas pikës 5 shtohen pikat 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 me këtë përmbajtje:

“6. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, krijimi dhe plotësimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit kryhet në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

7. Pavarësisht parashikimeve të pikës 5 të këtij neni, operatorëve ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë nuk u kërkohet të paraqesin dokumente mbështetëse ose prova të tjera dokumentare për atë pjesë të informacionit të deklaruar dhe të gjeneruar automatikisht në Sistemin e Prokurimit Elektronik si pjesë e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga ndërveprimi me sisteme të tjera elektronike.

8. Operatorët ekonomikë mund të përmbushin kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit edhe nëpërmjet dosjes virtuale të operatorit, e krijuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera elektronike për ruajtjen e dokumenteve. Dokumentet e dorëzuara si pjesë e dosjes virtuale të operatorit duhet të jenë të gjeneruara nga sisteme të tjera elektronike ose të noterizuara përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Operatorët ekonomikë janë përgjegjës për përditësimin e të dhënave në mënyrë automatike, për aq sa është e mundur, në dosjen virtuale të operatorit.

9. Për operatorët ekonomikë vendës, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit për aq sa është e zbatueshme.

10. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor për operatorët ekonomikë të huaj i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor në origjinal ose kopje të noterizuar dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike, të cilat nuk mund të gjenerohen automatikisht nga sistemet e tjera me anë të ndërveprimit. Dokumentet e noterizuara para noterëve publikë të Republikës së Shqipërisë dorëzohen online në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni sipas pikës 5 u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

11. Autoriteti ose enti kontraktor do të përdorë sistemin e-Certis për të marrë informacion për llojet dhe format e provave të përmendura në këtë nen dhe për autoritetet kompetente, që i lëshojnë ato në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.”.

Pika 5 e nenit 52 “Dispozita kalimtare” e ligjit nr.16/2024 ‘Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

5. Aktet nënligjore të nxjerra deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, që nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, do të zbatohen deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji. Çdo akt tjetër nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.”

Pika 2 e nenit 54 “Hyrja në fuqi” e ligjit nr.16/2024 ‘Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“2. Përjashtimisht, nenet 4, 11, 12, 13, 19, 20; neni 21; neni 22, pika 3; neni 24, pika 2; neni 25; neni 35, pika 3, neni 37, pikat 1 dhe 4; neni 44, pikat 2, shkronja “b”, dhe 3; neni 45, paragrafi i parë, togfjalëshi “përmes Sistemit të Menaxhimit të Kontratave”; neni 46; neni 47, pika 5, hyjnë në fuqi në datën e fillimit të funksionimit të Sistemit të Prokurimit Elektronik.” Referuar bazës ligjore të mësipërme, pretendimi i ofertuesit nuk qëndron.

- *Ofertuesi në ankesë pretendon:*

Në lidhje me këtë pretendim të AK, sqarojmë se, shoqëria jonë ka hedhur në tender dokumentacionin e plotë për Z. B.A i certifikuar edhe si elektrikist, Z.K.A. i certifikuar edhe si elektrikist, Z. A.M i certifikuar edhe si elektrikist, Znj. E.K. e certifikuar edhe si elektriciste, Znj. Xh.O., e certifikuar edhe si elektriciste, Znj. L.H., e certifikuar edhe si elektricistë, Z.A.A. i certifikuar edhe si elektrikist, Z.K.S. i certifikuar edhe si elektrikist.

Pra, nga ana jonë është paraqitur dokumentacion në tender për 8 persona, të kualifikuar dhe të certifikuar si elektricista, ndërkohë AK sqaron se janë vetëm 3. [...]. Bashkëlidhur çdo kontratë pune, do të gjeni edhe trajnimet përkatëse të tyre si elektricista apo të hedhura dokumentacionet në sistemin SPE. [...]. Po më tej, AK për kriterin për 15 elektricista na ka sqaruar se, konkretisht punonjëset Znj. E.K, dhe Znj. Xh. O. E. kanë kontratën e punës si nëpunëse finance, ndërsa Znj. L.H. e ka kontratën e punës si punonjëse shërbimi në zyrë, dhe nuk kanë certifikata provuese kualifikimi si elektricistë. [...].

Për të dy personat e mësipërm, Znj. E.K. dhe Znj. Xh.O., në kontratat e tyre respektive të paraqitura në tender në sistemin SPE, në nenin 1 të kontratës është rënë dakord që, këta punonjës do të kryejnë detyrën e ekonomistit për marketing dhe tjetra si nëpunëse finance, por pas kësaj fjale është edhe lidhëza/dhe vazhdon fjalia sipas nevojave profesionale të punës dhe shoqërisë. Gjithashtu, në fund të kontratave të punësimit, janë edhe certifikimet përkatëse si elektricista.

E njëjta gjë vlen për analogji edhe për Znj. L. H. ku në nenin 1 përveç punës si punonjëse shërbimi në zyrë, do të jetë edhe sipas nevojave profesionale të punës dhe të shoqërisë. Gjithashtu, në fund të kontratës, gjendet edhe certifikimi si elektricistë.

Në këto kushte, arsyeja e dhënë është antiligjore, pasi dokumentacioni gjendet i ngarkuar në tender, në origjinal. 6.Në DST janë kërkuar 2 teknike elektroteknike. Sipas dokumenteve provuese të sjella, nga operatori ekonomik “G.A.C” SHPK për Znj. L.D. nuk ka dëshmi kualifikimi për teknik elektroteknike, por ka diplomën për Inxhinier Informatike Ekonomike.

Lidhur me Znj. L.D. është paraqitur në tender në SPE kontrata e punës, diploma dhe pas diplomës do të gjeni certifikimin si teknik i lartë elektroteknik. [...].

Pra, pretendimi i AK nuk qëndron, pasi dokumentacioni, dëshmi kualifikimi sikurse AK pretendon, është hedhur në tender edhe certifikimi si teknik i lartë elektroteknik, pasi është Inxhinier. 7.Gjithashtu, në DST janë kërkuar tre drejtues mjeti. Operatori ekonomik “G.A.C” SHPK nuk ka paraqitur dokumentacion provues për një drejtues mjeti dhe konkretisht për Z.B.A.

Patenta e Z.B.A. është hedhur në tender dhe gjendet në SPE. Faqja e parë është karta e identitetit, faqja e dytë është patenta.

Përveç këtij personi, lejet e drejtimit janë hedhur edhe për shumë të tjerë si Z.K.S., Z.A.A. si dhe 1 nga subjekti mbështetës. Pavarësisht kësaj, për të tre personat e shoqërisë tonë, janë hedhur në tender dokumentacionet përkatëse provuese.

KSHA-ja arsyeton se:

Dokumenti që kërkohet për punonjës të specializuar/të kualifikuar është një dëshmi profesionale të punonjësve ose ekuivalenti i tij/saj, ofertuesi për disa punonjës ka paraqitur dëshmi kualifikimi për sigurimin teknik. Dokumenti i paraqitur nga ofertuesi “dëshmi kualifikimi për sigurimin teknik” nuk tregon/përfaqëson dëshminë profesionale të punonjësit, konkretisht dëshmia e kualifikimit për sigurimin teknik e z.E.C. Përderisa kjo kërkesë nuk plotësohet sipas kërkesës të kërkuar në dokumentet e tenderit, për ekonomi kohe nuk po i përmendim rastet e tjera.

Në këtë rast pretendimi i ofertuesit nuk qëndron.

- *Ofertuesi në ankesë pretendon:*

Ndodhur në kushtet e dokumenteve të pasakta, sipas formularit të vetëdeklarimit.

Nuk e kuptojmë se çfarë ka dashur të thotë personi që ka shqyrtuar dokumentacionin, sepse të gjitha sa janë përcaktuar në formularët përmbledhës të vetëdeklarimit, janë paraqitur në tender në sistemin online SPE, që në datën e hapjes së ofertave, pra nuk ka qenë ndonjë rrethanë që nuk ka qenë e paditur më parë nga AK.

9.KVO pas verifikimit ka pranuar si të parregullt dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “G.A.C” SHPK, duke e skualifikuar këtë ofertues.

Se çfarë kanë gjetur për arsye skualifikimi, mbetet në dorë të KPP verifikimi i kësaj ankese, pasi nga AK janë shkelur çdo dispozitë e mundshme ligjore dhe nënligjore, si dhe nga personat që kanë bërë anulimin e dytë, konstatohet skualifikim në kundërshtim me LPP-në.

Nje tjetër shkelje shumë e rëndë ka të bëjë me faktin se:

Tek pika 9, AK ka sqaruar se KVO pas verifikimit ka vendosur skualifikimin e ofertës tonë.

- *AK në vendimin e anulimit për herën e dytë na sqaron që KVO na ka skualifikuar. Pas ankesës së parë është ngritur një KSHA, të paktën 3 persona të tjerë, se kështu parashikon ligji, ndërkohë që KVO na ka skualifikuar.*
- *KVO e ka patur në dispozicion këtë dokumentacion që në datën e hapjes së procedurës, sepse ka qenë i gjithi i ngarkuar në SPE, ndërkohë në këtë vendim për herë të dytë për anulim na thonë për dokumentacionin e paraqitur. Përse janë mbajtur dy standarde vlerësimi, ku herën e parë nuk është parashtruar asnjë fakt i tillë?*
- *Sa herë kanë bërë vlerësime, kanë nxjerrë arsye të ndryshme.*
- *Kërkojmë në bazë të ligjit për informimin publik, emrat e anëtarëve të KVO-së, emrat e anëtarëve të KSHA 1, emrat e anëtarëve të KSHA 2 që do të shqyrtojnë këtë ankese, si dhe emrat e personave dhe profesionet se kush ka bërë anulimin e dytë.*
- *Kërkojmë nga KPP të marrë konfirmimin në APP përse ka vlerësuar KVO, ndërkohë që ka patur ankesa dhe duhej të ishin vlerësuar nga KSHA 1.*
- *Kërkojmë marrjen e të gjithë dosjes për dhe të gjitha procesverbaleve të mbajtura për vlerësim nga AK, si dhe verifikimin e numrave të protokollit të tyre.*
- *Kërkojmë për sa kemi parashtruar në këtë ankesë, verifikimin e dokumentacionit të paraqitur në tender nga ana jonë, në SPE, apo edhe dokumentacionin fizik, dhe të sqarojë përse nuk është dhënë si arsye që herën e parë, ndërkohë që dokumentacioni ishte i ngarkuar në sistemin SPE. [...]”*

KSHA arsyeton se:

Për sa kërkohet në pikat e mësipërme sqarojmë se përbërja e komisioneve nuk është tagër i KSHA-së, pasi pretendimi i ofertuesit konsiston në kompetencat që ka titullari i autoritetit

kontraktor në ngritjen e urdhërave për caktimin e personave të certifikuar në fushën e prokurimit publik. Gjithashtu edhe kërkesat që i përkasin KPP-së nuk përbëjnë objekt shqyrtimi për KSHA pranë Bashkisë Durrës.

Për sa trajtuar më lart, KSHA vendos pranimin pjesërisht të ankesës së ofertuesit “G.A.C” SHPK .”

II.20. Nëpërmjet shkresës nr. 3230/5 prot., datë 06.12.2024 me objekt: *“Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së dhe dokumentacioni, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “G.A.C” SHPK”,* Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, shoqëruar me procesverbalet e punës së KVO-së dhe KSHA-së si dhe dokumentacionin provues të shoqërisë “G.A.C” SHPK që vërteton përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor objekt ankimimi, sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, të njehsuara me vulën e institucionit tuaj.

II.21. Në datën 17.12.2024 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 3230/6 prot., shkresa e autoritetit kontraktor Bashkia Durrës me nr. 3326/21 prot., datë 13.12.2024 me objekt: *“Dërgim informacioni dhe dokumentacioni të nevojshëm mbi shqyrtimin e ankesës për procedurën me objekt ankimimi: “Rehabilitimi i ndriçimit të akseve rrugore në qytetin e Durrësit”, bashkëngjitur dokumentacioni i mëposhtëm:*

1. Procesverbal i hapjes së ofertave të dates 05.06.2024, ora 10.00, të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (në vijim KVO).
2. Procesverbal shqyrtimi dhe vlerësimi i datës 28.06.2024, të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (në vijim KVO).
3. Formularin e njoftimit të anulimit të procedurës së mësipërme i datës 28.06.2024.
4. Urdhër për ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (në vijim KSH A) me Nr.231, datë 09.07.2024 e nr.3326/7 prot.
5. Vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës (në vijim KSHA) ni. 3326/8 prot., datë 17.07.2024, mbi ankesat e operatorëve ekonomik: “G.A.C” Shpk, “ASI-2A CO” Shpk dhe BOE “K.M.K” Shpk & “Caushi M” Shpk.
6. Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik (në vijim KPP) Nr. 941/2024, datë 22.07.2024 e nr. 1794/8 prot.
7. Procesverbal rivlerësimi i datës 19.08.2024, të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (në vijim KVO).
8. Procesverbal mbi vlerësimin e dokumentacionit provues për vetëdeklarimet dhe dokumenteve të paraqitura në rrugë elektronike i datës 27.08.2024 të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (në vijim KVO).
9. Procesverbal rivlerësimi i datës 27.08.2024, të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (në vijim KVO).
10. Procesverbal mbi vlerësimin e dokumentacionit provues për vetëdeklarimet dhe dokumenteve të paraqitura në rrugë elektronike i datës 07.10.2024 të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (në vijim KVO).
11. Procesverbal rivlerësimi i datës 07.10.2024, të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (në vijim KVO).

12. Procesverbal mbi vlerësimin e dokumentacionit provues për vetëdeklarimet dhe dokumenteve të paraqitura në rrugë elektronike i datës 28.10.2024 të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (në vijim KVO).
13. Procesverbal rivlerësimi i datës 28.10.2024, të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (në vijim KVO).
14. Formularin e njoftimit të anulimit të procedurës së mësipërme i datës 29.10.2024.
15. Urdhër për ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (në vijim KSHA) me Nr.425, datë 07.11.2024 e nr.3326/18 prot.
16. Vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës (në vijim KSHA) m.3326/19 prot., datë 21.11.2024, mbi ankesën e operatorit ekonomik “G.A.C” Shpk, për procedurën e prokurimit me objekt: “Rehabilitim i ndriçimit të akseve rrugore në qytetin e Durrësit”. Gjithsej 54 (pesëdhjetë e katër) fletë, në fotokopje.
17. DVD-R në përmbajtje të së cilës gjendet i gjithë dokumentacioni provues i operatorit ekonomik ankimues “G.A.C” shpk.

II.22. Nëpërmjet shkresës nr. 3230/7 prot., datë 20.12.2024 me objekt: “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së dhe dokumentacioni, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “G.A.C” SHPK”, Komisioni i Prokurimit Publik i rikërkoi autoritetit kontraktor informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, shoqëruar si më poshtë vijon:

“Në datën 17.12.2024 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 3230/6 prot., shkresa e autoritetit kontraktor Bashkia Durrës me nr. 3326/21 prot., datë 13.12.2024 me objekt: “Dërgim informacioni dhe dokumentacioni të nevojshëm mbi shqyrtimin e ankesës për procedurën me objekt ankimimi: “Rehabilitimi i ndriçimit të akseve rrugore në qytetin e Durrësit”, bashkëngjitur dokumentacioni si vijon: Procesverbal i hapjes së ofertave të dates 05.06.2024; Procesverbal shqyrtimi dhe vlerësimi i datës 28.06.2024, të KVO-së; Formulari i njoftimit të anulimit të procedurës së mësipërme i datës 28.06.2024; Urdhëri për ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave Nr.231, datë 09.07.2024 e nr.3326/7 prot; Vendimi i KSHA-së mbi ankesat e operatorëve ekonomik: “G.A.C” Shpk, “ASI-2A CO” Shpk dhe BOE “K.M.K” Shpk & “Caushi M” Shpk; Vendimi i KPP-së Nr. 941/2024, datë 22.07.2024 e nr. 1794/8 prot; Procesverbal rivlerësimi i datës 19.08.2024, të KVO-së; Procesverbal mbi vlerësimin e dokumentacionit provues për vetëdeklarimet dhe dokumenteve të paraqitura në rrugë elektronike i datës 27.08.2024 të KVO-së; Procesverbal rivlerësimi i datës 27.08.2024, të KVO-së; Procesverbal mbi vlerësimin e dokumentacionit provues për vetëdeklarimet dhe dokumenteve të paraqitura në rrugë elektronike i datës 07.10.2024; Procesverbal rivlerësimi i datës 07.10.2024; Procesverbal mbi vlerësimin e dokumentacionit provues për vetëdeklarimet dhe dokumenteve të paraqitura në rrugë elektronike i datës 28.10.2024; Procesverbal rivlerësimi i datës 28.10.2024; Formulari i njoftimit të anulimit të procedurës së mësipërme i datës 29.10.2024; Urdhëri për ngritjen e KSHA me Nr.425, datë 07.11.2024 e nr.3326/18 prot; Vendimi i KSHA-së nr.3326/19 prot., datë 21.11.2024, mbi ankesën e operatorit ekonomik “G.A.C” Shpk; DVD-R me dokumentacionin e ofetuesit “G.A.C” shpk. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ana e autoritetit kontraktor nuk rezulton i qartë informacioni mbi qëndrimin e KSHA-së përsa i përket mangësive të konstatuara në dokumentacionin e subjektit mbështesës të shoqërisë “G.A.C” shpk, si dhe nuk është paraqitur

në KPP dokumentacioni provues që shoqërisë “G.A.C” SHPK ka dorëzuar në AK që vërteton përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor objekt ankimimi, sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, të njehsuara me vulën e institucionit tuaj.”

II.23. Në datën 31.12.2024 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 3230/8 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr 3326/23 prot., datë 27.12.2024 me objekt: *“Dërgim dokumentacioni provues të nevojshëm mbi shqyrtimin e ankesës për procedurën me objekt-ankimimi: “Rehabilitimi i ndriçimit të akseve rrugore në qytetin e Durrësit”, bashkëngjitur dokumentacioni provues i operatorit ekonomik “G.A.C” SHPK, i dorëzuar pranë AK-së në datën 09.10.2024.*

II.24. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëlidhur saj si dhe informacionit e dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “G.A.C” SHPK për skualifikimin e tij të padrejtë nga ana e KVO-së, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Me anë të shkresës me Nr. 3326/21 prot., datë 25.11.2024, protokolluar me tonë me nr. 3230/4 prot., datë 26.11.2024,, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “G.A.C” SHPK, sipas së cilës është vendosur pranim i pjesshëm i ankesës.

III.1.2. Referuar Vendimit të KSHA-së me nr. Nr. 3326/19 prot., datë 21.11.2024, me objekt: *“Mbi ankesën e operatorit ekonomik “G.A.C” SHPK për procedurën me objekt: “Rehabilitimi i ndriçimit të akseve rrugore në qytetin e Durrësit”, rezulton, se KSHA ka pranuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “G.A.C” SHPK, duke argumentuar si më poshtë:*

“Ofertuesi në ankesë pretendon: 1.Referuar shtojcës 7 kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit citohet se: Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, vetë deklarimi sipas shtojcës 8 do të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës. Referuar kësaj arsyeje të dhënë në arsyet e skualifikimit për anulimin e herës së dytë, ju bëjmë me dije se, subjekti mbështetës, ka paraqitur në tender formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.[...]. Gjithashtu, referuar arsyeve të dhëna herën e parë, AK ka pranuar që formulari i vetëdeklarimit të paraqitur në tender nga subjekti mbështetës nuk e ka plotësuar atë konform ligjit, duke na skualifikuar. Pas ankesës së herës së parë, na kualifikojnë, pra që vetë AK ka pranuar që është paraqitur. Ndërkohë, këtë herë të dytë anulimi, na japin si arsye skualifikimi që mbështetës nuk ka paraqitur në tender këtë formular, pretendim ky

absurd, dhe i pavërtetë, pasi në tender është paraqitur si formulari i vetëdeklarimit nga ana jonë, ashtu edhe ajo e subjektit mbështetës. [...]. Në këto kushte, arsyeja e parë e dhënë për skualifikim për anullimin e dytë është totalisht antiligjore, ku formulari i subjektit mbështetës, gjendet i ngarkuar në SPE. Referuar dokumentacionit të paraqitur në dosjen fizike, konstatohet se, subjekti mbështetës “Sh.I.” nuk ka paraqitur dokumenta provues të shtojcës 8 për kapitullin kritere të përgjithshme të përzgjedhjes së kualifikimit. Në lidhje me këtë pretendim, sqarojmë se, nga ana e shoqërisë tonë është paraqitur në tender, në fazën fillestare i gjithë informacioni dhe dokumentacioni provues, përfshirë edhe dokumentacionin e subjektit mbështetës. Pra, çdo dokument është paraqitur on line në SPE, për të cilën AK nuk ka ngritur asnjë pretendim. Pra, nuk është dokumentacion që është dorëzuar vetëm bazuar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, por është paraqitur në tender i gjithi, në SPE. Në rast se do të kishin pretendime, AK duhej të kishte dhënë si arsye skualifikimi që herën e parë që u anulua ky tender dhe oferta jonë u skualifikua. Pra është një pretendim i dhënë pas tejkalimit të çdo afati të mundshëm ligjor kohor.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës arsyeton:

Në lidhje me këtë pretendim të ofertuesit se është paraqitur në tender, që në fazën fillestare i gjithë informacioni dhe dokumentacioni provues, përfshirë edhe dokumentacionin e subjektit mbështetës, në këtë rast pretendimi i ofertuesit nuk qëndron pasi neni 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregulave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon: “Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: -ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës; -t’i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme. -t’i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së. Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.”

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar si më poshtë vijon:

“Për ofertuesit G.A.C shpk me NIPT: L61619031A me vlerë të ofertës 19,639,471 [nëntëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një] lekë pa T.V.SH , Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kritereve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik, “G.A.C” shpk, ka një kontratë angazhimi mbi mbështetjen në kapacitetet teknike me subjektin “Shansi invest”shpk. - Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të subjektit “Shansi Invest” u konstatua se e ka plotësuar në mënyrë të gabuar këtë formular. Konkretisht tek Pjesa II “Shkaqet e përjashtimit”, paragrafi B “Deklarata”, pika 6 duke e lënë të pa plotësuar. - Tek pjesa e tretë e shtojcës 8, “Kriteret e përzgjedhjes së kualifikimit”, paragrafi D “Deklaratë mbi mos angazhimin e kapaciteteve teknike në kontratat e tjera” te kritereve të veçanta te kualifikimit, “Shansi Invest” shpk stafin teknik mbështetës në mbështetje të subjektit “GAC”shpk nuk e deklaroi nëse e ka të angazhuar apo jo. Mbështetur në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, të ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, KVO vendos që ofertuesit “G.A.C” shpk të mos kualifikohet”.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka vlerësuar si më poshtë vijon:

Lidhur me ankesën e OE, ankues "G.A.C" shpk me NIPT L61619031A, sqarojmë se objekti i ankesës lidhet me skualifikimin e OE nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për mospërbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në Dokumentet e tenderit, dhe konkretisht për pikat si vijon, duke cilësuar.

Operatori Ekonomik "G.A.C" shpk, ka një kontratë angazhimi mbi mbështetjen në kapacitetet teknike me subjektin "Shansi Invest" shpk.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të subjektit "Shansi Invest" u konstatua se e ka plotësuar në mënyrë të gabuar këtë formular. Konkretisht tek Pjesa II "Shkaqet e përjashtimit", paragrafi B "Deklarata", pike 6 duke e lënë të paplotësuar.

Tek pjesa e tretë e shtojcës 8, "Kriteret e përzgjedhjes së kualifikimit", paragrafi D "Deklaratë mbi mos angazhimin e kapaciteteve teknike në kontratat e tjera" të kriterëve të vecanta të kualifikimit "Shansi Invest" shpk stafin teknik mbështetës në mbështetje të subjektit "GAC" shpk nuk e deklaroi nëse e ka të angazhuar apo jo."

Pas vlerësimit të dokumentacionit nga KSHA, konstatohet se: Në dokumentet e tenderit të kërkuar në këtë procedurë prokurimi, përcaktohet se: Në rast se operatorët ekonomikë ofertues do të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, një formulari veçantë i vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës. [...]. Në nenin 90, pika 7 të VKM-së nr.285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, përcaktohet saktë: Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit. Në këto kushte subjekti "Shansi Invest" SHPK në cilësinë e subjektit mbështetës nuk ka detyrimin ligjor ta plotësojë pikën 6, paragrafi B "Deklarata" të pjesës II, kriter i cili duhet të plotësohet vetëm nga ofertuesi.

Lidhur me pikën e parë të ankesës KSHA vlerëson se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron dhe ankesa duhet pranuar.

Sa i përket pikës së dytë të ankesës ku citohet nga KVO:

Tek pjesa e tretë e shtojcës 8, "Kriteret e përzgjedhjes së kualifikimit", paragrafi D "Deklaratë mbi mos angazhimin e kapaciteteve teknike në kontratat e tjera" të kriterëve të veçantë të kualifikimit, "Shansi Invest" shpk stafin teknik mbështetës në mbështetje të subjektit "GAC" shpk nuk e deklaroi nëse e ka të angazhuar apo jo. [...]", KSHA konstaton se:

Në dokumentet e tenderit autoriteti kontraktor Bashkia Durrës, në shtojcën 7, pika 2 Kriteret e veçantë, ndër të tjera ka kërkuar edhe:

2.3.3.Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

b. Inxhinier Elektrik 1 (një)

Për stafin e sipërcituar të paraqesë dokumentacion që vërteton profesionin si: dëshmi profesionale (diploma e inxhinierëve) ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune. Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST.

2.3.4.Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

c. Inxhinier Gjeodet 1 (një)

d. Teknik ndertimi 1 (një)

Për stafin e sipërcituar të disponojë dokumentacion që vërteton profesionin si: diploma e inxhinierëve dhe kontrata pune. Për stafin e sipërcituar të disponojë dokumentacion që vërteton profesionin si: Dëshmi profesionale e teknikut të ndërtimit ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune. Ndërsa për punëtorë të thjeshtë, të disponojë një vetëdeklarim nga shoqëria, ku listohen si punëtorë të thjeshtë

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST

2.3.5.Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- | | |
|-------------------------|--------------------|
| a. Teknik Ndërtimi | 3 (tre) |
| b. Elektracist | 15 (pesëmbëdhjetë) |
| c. Teknik Elektroteknik | 2 (dy) |
| d. Manovratorë | 1 (një) |
| e. Drejtues Mjeti | 3 (tre) |
| f. Punëtor të thjeshtë | 15 (pesëmbëdhjetë) |

Për stafin e sipërcituar të disponojë dokumentacion që vërteton profesionin si: dëshmi profesionale të punonjësve ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune. Ndërsa për punëtorë të thjeshtë ndërtimi, të disponojë një vetëdeklarim nga shoqëria, ku listohen si punëtorë të thjeshtë ndërtimi. Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST.

Nga sa shihet më sipër autoriteti kontraktor në kriteret kualifikuese të përcaktuara përkatësisht në pikat 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5 të shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit nuk ka kërkuar që operatori ekonomi të deklarojë se stafi inxhinierik, stafi i specialistëve, punonjësit e specializuar, nuk duhet të jenë të angazhuar edhe në objekte të tjera. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga shoqëria ankuese “G.A.C” SHPK dhe konkretisht i shtojcës 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të datës 05.06.2024, deklaratë e subjektit mbështetës “Shansi Invest” SHPK, për përmbushjen e kriterëve kualifikuese të përcaktuara në pikat 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5 të shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit, lidhur me dipsonimin e stafit, KSHA gjykon se i ka plotësuar kriteret kualifikuese të sipërpërmendura, duke dëshmuar se disponon stafin e kërkuar. Njëkohësisht sqarojmë se operatori ekonomik ofertues “G.A.C” SHPK e ka paraqitur shtojcën 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të plotësuar, duke dëshmuar se disponon stafin e kërkuar nga AK për zbatimin e kësaj kontrate.

Lidhur me pikën e dytë të ankesës, KSHA vlerëson se pretendimi i Operatorit ekonomik ankues qëndron dhe ankesa duhet pranuar.

Duke analizuar vlerësimin e KVO-së dhe pretendimet që ngrihen nga ofertuesi, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës konstaton se KVO duhet ti kishte nxjerre pretendimet që në momentin e vlerësimit në SPE për arsyen se ofertuesi nuk i ka ndryshuar dokumenta e vetëdeklarimit, pra ato dokumenta që ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit po ato dokumenta njëkohësisht i ka ngarkuar në edhe në SPE, në këto momente KVO duhet ta kishte bërë me dije për mosplotësimin e tyre. Theksojmë se procedura ka vazhduar me ankesën e ofertuesit dhe është pranuar nga KSHA duke e kualifikuar ofertuesin njëkohësisht është dhënë dhe vendimi deklarativ nga KPP. Me të drejtë ofertuesi ngre pretendimin për dokumentacionin e

dorëzuar fizikisht, pasi është i njëjti dokumentacion i dorëzuar ne SPE, pra pretendimi i ofertuesit në këtë rast qëndron. Ndërkohë KVO nuk është referuar mbi dokumentacionin e dorëzuar nga ofertuesi ne SPE, por është bazuar vetëm tek vetëdeklarimi i ofertuesit dhe e ka konsideruar të rregullt.

Pika 4 e nenit 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimi publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.” Ligjvënësi ka parashikuar se ofertuesi duhet të vërtetojë me dokumentacion provues se për subjektin mbështetës nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikim sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, në rastin se ekzistojnë shkaqet për skualifikim autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit që të zëvendësojë subjektin.”

III.1.3. Për sa më sipër, referuar nenit 115, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se: “2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.” Komisioni i Prokurimit Publik vendos të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “G.A.C” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Komisioni do të vijojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

III.2. Lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “G.A.C” SHPK se: “Sipas kontratës së angazhimit operatori ekonomik G.A.C do të mbështetej tek subjekti Shansi Invest” shpk me 12 persona me profesion elektrikist. Pas verifikimit të dokumentacionit provues për këta punonjës u konstatua se nuk kishte dokument provues të kualifikimit të tyre si elektrikista. Ndërsa vetë operatori ekonomik “G.A.C.” shpk do të kishte tre punonjës elektrikist. Pas verifikimit të dokumentacionit provues për këta tre punonjës u konstatua që ky dokumentacion kishte parregullsi, mos përputhje duke mos vërtetuar profesionin e tyre si elektrikista. Konkretisht punonjëset E. K dhe Xh.O e kanë kontratën e punës si nëpunëse finance ndërsa L.H e ka kontratën e punës si punonjëse shërbimi në zyrë dhe nuk kanë certifikata provuese kualifikimi si elektrikistë.

Në DST pjesë e procedurës së tenderit janë kërkuar 2 teknik elektroteknik. Sipas dokumentave provuese të sjella nga operatori ekonomik “G.A.C” shpk për L. D nuk ka dëshmi kualifikimi për teknik elektroteknik por ka diplomë për Ing.Informatik Ekonomike. Gjithashtu sipas DST janë kërkuar gjithashtu 3 drejtues mjeti. Operatori ekonomik “G.A.C” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion provues për një drejtues mjeti dhe konkretisht për B. A. Ndodhur në kushtet e dokumentave të pa sakta sipas formularit të vetdeklarimit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranon si të parregullt dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “G.A.C.” shpk,

me vlerë të ofertës 19.639.471 lekë, duke e skualifikuar këtë ofertues.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.5 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, të publikuara në SPE, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kriterëve për punonjës të specializuar/të kualifikuar si më poshtë vijon:

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- | | |
|-------------------------|--------------------|
| a. Teknik Ndërtimi | 3 (tre) |
| b. Elektricitist | 15 (pesëmbëdhjetë) |
| c. Teknik Elektroteknik | 2 (dy) |
| d. Manovratorë | 1 (një) |
| e. Drejtues Mjeti | 3 (tre) |
| f. Punëtor të thjeshtë | 15 (pesëmbëdhjetë) |

Për stafin e sipërcituar të disponojë dokumentacion që vërteton profesionin si: dëshmi profesionale të punonjësve ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune. Ndërsa për punëtorë të thjeshtë ndërtimi, të disponojë një vetëdeklarim nga shoqëria, ku listohen si punëtorë të thjeshtë ndërtimi. Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST.

III.2.2. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 1/a, thuhet se:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

III.2.3. Në shtojcën 8, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pjesë e dokumentave të tenderit, Pjesa III “Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit”, gërma “B” Deklaratë “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen) është kërkuar si vijon:

Unë kam punonjës të nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Nëse, po, numri i punonjësve:

	Profili i punonjësve

	<u>Makineri e mjete</u>
Po [] Jo []	
Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:	

Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

III.2.4. Nga verifikimi i ofertës së operatorit ekonomik “G.A.C” SHPK rezulton se është paraqitur dokumentacioni si vijon:

1. Shtojca 8, “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” i operatorit ekonomik “G.A.C” SHPK,
2. Shtojca 8, “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” i operatorit ekonomik “Shansi Invest” SHPK
3. Kontratë angazhimi me shkrim me datë 05.06.2024 e lidhur midis shoqërisë “Shansi Invest” SHPK dhe shoqërisë “G.A.C” SHPK dhe e nënshkruar nga të dyja palët. Qëllimi i kontratës është mbështetja e shoqërisë “G.A.C” SHPK në kapacitetet e shoqërisë “Shansi Invest” SHPK, për procedurën e prokurimit objekt ankimi. Sipas kësaj kontrate, shoqëria “Shansi Invest” SHPK pranon të vërë në dispozicion të shoqërisë “G.A.C” SHPK dhe shoqëria “G.A.C” SHPK pranon të mbështetet në kapacitetet e shoqërisë “Shansi Invest” SHPK, përveç të tjerave, për dy persona teknik ndërtimi, 12 persona elektrikist dhe 1 person manovrator, duke përcaktuar edhe emrat përkatës të secilit individ.

III.2.5. Në ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “G.A.C” SHPK, pretendohet si vijon: *“Në DST kërkohen 15 elektrikista. Për një pjesë të kapacitetit, operatori “G.A.C” SHPK ka kërkuar të mbështetet në kapacitetet teknike të subjektit “Sh.I.” SHPK, duke nënshkruar një kontratë angazhimi dhe të vetëdeklaruar në shtojcën nr. 8. Sipas kontratës së angazhimit shoqëria “G.A.C” SHPK do të mbështetet për 12 persona, me profesion elektrikistë. Pas verifikimit të dokumentacionit provues për këta punonjës u konstatua se nuk kishte dokument provues të kualifikimit të tyre si elektrikista. Në lidhje me këtë pretendim, kërkoj më nga KPP të verifikojë dokumentacionin e paraqitur në tender, pra në SPE, sepse nga ana jonë është dorëzuar i gjithë dokumentacioni që në fillim, NË DATEN E HAPJES SË OFERTAVE. [...]*

Ju sqarojmë se, numri prej 15 personash tejkalohej shumfish, pasi dhe nga ana jonë është paraqitur një numër shumë i lartë elektrikistash, ndërkohë që nga subjekti mbështetës na janë vënë në dispozicion edhe 12 të tillë të tjerë. [...]. Kërkojmë nga KPP, të verifikojë kontratën e angazhimit, si dhe formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të subjektit mbështetës, nga ku do të provoni dhe vërtetoni se për të 12 personat janë hedhur në tender në sistemin SPE kontratat e punës që këta punonjës kanë me subjektin mbështetës, listëpagesat e subjektit mbështetës ku provohet se janë të punësuar pranë kësaj shoqërie, si dhe në fund të çdo kontrate punësimi, për të 12 personat gjendet dëshmitë e sigurimit dhe kualifikimit si elektrikista. [...]. 4. Lidhur po me kriterin për 15 elektrikista, AK sqaron se, “G.A.C” SHPK do të kishte tre punonjës elektrikistë. Pas verifikimit të dokumentacionit, për këta tre punonjës u konstatua se ky dokumentacion kishte parregullsi, mos përputhje duke mos vërtetuar profesionin e tyre si elektrikista. Në lidhje me këtë pretendim të AK, sqarojmë se, shoqëria jonë ka hedhur në tender dokumentacionin e plotë për Z. B.A i certifikuar edhe si elektrikist, Z.K.A. i certifikuar edhe si elektrikist, Z. A.M i certifikuar edhe si elektrikist, Znj. E.K. e certifikuar edhe si elektriciste, Znj. Xh.O., e certifikuar edhe si elektriciste, Znj. L.H., e certifikuar edhe si elektriciste, Z.A.A. i certifikuar edhe si elektrikist, Z.K.S. i certifikuar edhe si elektrikist. Pra, nga ana jonë është paraqitur dokumentacion në tender për 8 persona, të kualifikuar dhe të certifikuar si elektrikista, ndërkohë AK sqaron se janë vetëm 3. [...].

Bashkëlidhur çdo kontrate pune, do të gjeni edhe trajnimet përkatëse të tyre si elektrikista apo të hedhura dokumentacionet në sistemin SPE. [...]. 5. Po më tej, AK për kriterin për 15 elektrikista na ka sqaruar se, konkretisht punonjëset Znj. E.K, dhe Znj. Xh. O. E. kanë kontratën

e punës si nëpunëse finance, ndërsa Znj. L.H. e ka kontratën e punës si punonjëse shërbimi në zyrë, dhe nuk kanë certifikata provuese kualifikimi si elektrikistë. [...]. Për të dy personat e mësipërm, Znj. E.K. dhe Znj. Xh.O., në kontratat e tyre respektive të paraqitura në tender në sistemin SPE, në nenin 1 të kontratës është rënë dakord që, këta punonjës do të kryejnë detyrën e ekonomistit për marketing dhe tjetra si nëpunëse finance, por pas kësaj fjale është edhe lidhësa /, dhe vazhdon fjalia sipas nevojave profesionale të punës dhe shoqërisë. Gjithashtu, në fund të kontratave të punësimit, janë edhe certifikimet përkatëse si elektrikista. E njëjta gjë vlen për analogji edhe për Znj. L. H. ku në nenin 1 përveç punës si punonjëse shërbimi në zyrë, do të jetë edhe sipas nevojave profesionale të punës dhe të shoqërisë. Gjithashtu, në fund të kontratës, gjendet edhe certifikimi si elektrikistë.

Në këto kushte, arsyeja e dhënë është antiligjore, pasi dokumentacioni gjendet i ngarkuar në tender, në origjinal.

6.Në DST janë kërkuar 2 teknikë elektroteknikë. Sipas dokumenteve provuese të sjella, nga operatori ekonomik “G.A.C” SHPK për Znj. L.D. nuk ka dëshmi kualifikimi për teknik elektroteknikë, por ka diplomën për Inxhinier Informatik Ekonomike. Lidhur me Znj. L.D. është paraqitur në tender në SPE kontrata e punës, diploma dhe pas diplomës do të gjeni certifikimin si teknik i lartë elektroteknik. [...].

Pra, pretendimi i AK nuk qëndron, pasi dokumentacioni, dëshmi kualifikimi sikurse AK pretendon, është hedhur në tender edhe certifikimi si teknik i lartë elektroteknik, pasi është Inxhinier.

7.Gjithashtu, në DST janë kërkuar tre drejtues mjeti. Operatori ekonomik “G.A.C” SHPK nuk ka paraqitur dokumentacion provues për një drejtues mjeti dhe konkretisht për Z.B.A. Patenta e Z.B.A. është hedhur në tender dhe gjendet në SPE. Faqja e parë është karta e identitetit, faqja e dytë është patenta. Përveç këtij personi, lejet e drejtimit janë hedhur edhe për shumë të tjerë si Z.K.S., Z.A.A. si dhe 1 nga subjekti mbështetës. Pavarësisht kësaj, për të tre personat e shoqërisë tonë, janë hedhur në tender dokumentacionet përkatëse provuese.

III.2.6. Referuar Vendimit të KSHA-së me nr. Nr. 3326/19 prot., datë 21.11.2024, me objekt: “Mbi ankesën e operatorit ekonomik “G.A.C” SHPK për procedurën me objekt: “Rehabilitim i ndricimit të akseve rrugore në qytetin e Durrësit”, rezulton, se KSHA ka refuzuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “G.A.C” SHPK, duke arsyetuar shprehimisht se: “Dokumenti që kërkohet për punonjës të specializuar/të kualifikuar është një dëshmi profesionale të punonjësve ose ekuivalenti i tij/saj, ofertuesi për disa punonjës ka paraqitur dëshmi kualifikimi për sigurimin teknik. Dokumenti i paraqitur nga ofertuesi “dëshmi kualifikimi për sigurimin teknik” nuk tregon/përfaqëson dëshminë profesionale të punonjësit, konkretisht dëshmia e kualifikimit për sigurimin teknik e Z.E.C. Përderisa kjo kërkesë nuk plotësohet sipas kërkesës të kërkuar në dokumentat e tenderit, për ekonomi kohe nuk po i përmendim rastet e tjera. Në këtë rast pretendimi i ofertuesit nuk qëndron.”

III.2.7. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të

barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktorë garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktorë nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 8 3. Autoritetet dhe entet kontraktorë janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor i LPP-së parashikon se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”*

III.2.8. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktorë përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktorë mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktorë mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktorë mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet

kontraktorë mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktorë mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktorë, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktorë përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.9. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktorë pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohej për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.2.10. Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.

2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.

3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.

5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes.

6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm.

7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.”.

III.2.11. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

III.2.12. Në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.

2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;

- t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.

- t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.

- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër.

4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës.

5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm.

6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.

7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit. Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi.”

III.2.13. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen

ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe të veprojë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.2.14. Komisioni gjykon se, referuar nenit 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohen kapacitetet mbi të cilat mund të mbështetesh tek një operator ekonomik, konkretisht parashikohet se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Ndërsa në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se 1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së. 2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës; - t’i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme; - t’i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së; - Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor. Në Nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht, se për pikën 1 të nenit 76 të Ligjit “Për Prokurimin Publik”, nga ana e operatorit ekonomik duhet të plotësohet formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në rregullat e prokurimit publik. Referuar dokumenteve të tenderit, në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, në pjesën e fundit

përcaktohet, se “në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës”.

Në ofertën e paraqitur në SPE, rezulton se operatori ekonomik ankimues “G.A.C” SHPK, do të mbështetet në kapacitetet e operatorin ekonomik “Shansi Invest” SHPK, ku përveç Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të tij, ka paraqitur edhe Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Shansi Invest” SHPK si dhe një kontratë angazhimi me shkrim ku janë përcaktuar kapacitetet konkrete që shoqëria “Shansi Invest” SHPK pranon të vërë në dispozicion të shoqërisë “GAC” SHPK dhe shoqëria “G.A.C” SHPK pranon të mbështetet në kapacitetet e shoqërisë “Shansi Invest” SHPK, përveç të tjerave, për dy persona teknik ndërtimi, 12 persona elektrikist dhe 1 person manovrator, duke përcaktuar edhe emrat përkatës të secilit individ. Gjithashtu rezulton se është paraqitur Shtojca 8, “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” i operatorit ekonomik “G.A.C” SHPK, ku në pjesën III të saj “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, germa “B” Deklaratë “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate, është deklaruar si vijon: *Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.*

Konkretisht është deklaruar si vijon:

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontratë”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Punonjës Po ☒ Jo ☐ Nëse, po, numri i punonjësve: Sipas dokumentacionit të paraqitur në tender. Prill 2024 – 22 punonjës.
	Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: 1. L. Z. me profesion Inxhinier, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Inxhinierit Elektrik, sipas dokumentacionit të paraqitur në tender. 2. A. M. me profesion punonjës, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin edhe të Teknik Ndërtimi, sipas dokumentacionit të

	paraqitur në tender.
	3. A. A. , me profesion punonjës, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin edhe të Teknik Ndërtimi , sipas dokumentacionit të paraqitur në tender.
	4. E. A. me profesion punonjës, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin edhe të Elektricitist , sipas dokumentacionit të paraqitur në tender.
	5. K. A. , me profesion Administrator, i certifikuar edhe në rolin edhe të Elektricitist , sipas dokumentacionit të paraqitur në tender.
	6. A. M me profesion Teknik, i certifikuar edhe në rolin edhe të Elektricitist , sipas dokumentacionit të paraqitur në tender.
	7. E. K , punonjëse, e certifikuar edhe në rolin edhe të Elektricitist , sipas dokumentacionit të paraqitur në tender.
	8. Xh. O , punonjëse, e certifikuar edhe në rolin edhe të Elektricitist , sipas dokumentacionit të paraqitur në tender.
	9. L. H punonjëse, e certifikuar edhe në rolin edhe të Elektricitist , sipas dokumentacionit të paraqitur në tender.
	10. A. A. me profesion Teknik, i certifikuar edhe në rolin edhe të Elektricitist , sipas dokumentacionit të paraqitur në tender.
	11. K. S me profesion punonjës ndërtimi, i certifikuar edhe në rolin edhe të Elektricitist , sipas dokumentacionit të paraqitur në tender.
	12. D. S me profesion IT, i certifikuar edhe në rolin edhe të Teknik i Lartë Elektroteknik,

G.A.C

	sipas dokumentacionit të paraqitur në tender.
	13. L. D. me profesion IT Informatike, i çertifikuar edhe në rolin edhe të Teknik i Lartë Elektroteknik , sipas dokumentacionit të paraqitur në tender.
	14. B. A. me profesion punonjës, i çertifikuar edhe në rolin edhe të Drejtues Mjeti , sipas dokumentacionit të paraqitur në tender.
	15. A. A. me profesion Teknik, i çertifikuar edhe në rolin edhe të Drejtues Mjeti , sipas dokumentacionit të paraqitur në tender.
	16. K. S. me profesion punonjës ndërtimi, i çertifikuar edhe në rolin edhe të Drejtues Mjeti , sipas dokumentacionit të paraqitur në tender.
	17. L. H. E. K. M. St. A. M. D. M. H. Li. Xh. O. B. A. etj, sipas procesve të punës dhe grafikut të punimeve të AK, që këta do të jenë edhe si punonjës të thjeshtë do të duhen të punojnë në objekt, sipas dokumentacionit të paraqitur në tender.
	18. I. H. me profesion punonjës ndërtimi, i çertifikuar dhe diplomuar edhe në rolin edhe të Topografit , sipas dokumentacionit të paraqitur në tender.

Pra rezulton se operatori ekonomik “G.A.C” SHPK ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (pwrvec tw tjerave), se disponon 8 punonjës me profesion elektrikistë, 2 punonjës teknik i lartë elektroteknik dhe 3 punonjës drejtues mjeti.

III.2.14.1. Përsa i përket punonjësve me profesion “elektricitist”, në klasifikimin përfundimtar të ofertave, ankimuesi është njoftuar elektronikisht nga KVO se “operatori ekonomik “G.A.C.” shpk do të kishte tre punonjës elektrikist. Pas verifikimit të dokumentacionit provues për këta tre punonjës u konstatua që ky dokumentacion kishte parregullsi, mos përputhje duke mos vërtetuar profesionin e tyre si elektrikista. Konkretisht punonjëset Esmerina Koçi dhe Xhoela Ospa e kanë kontratën e punës si nënpunëse finance ndërsa Limone Harizi e ka kontratën e punës si punonjëse shërbimi në zyra dhe nuk kanë çertifikata provuese kualifikimi si elektrikistë”, ndërkohë që operatori ekonomik “G.A.C.” SHPK ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit se disponon 8 punonjës me profesion elektrikista, dhe jo tre siç pretendon KVO-ja. Kërkesa e AK-së është për 15 punonjës elektrikistë. Edhe në supozimin se këta tre punonjës nuk plotësonin kërkesat e parashikuara në DT, ankimuesi ka deklaruar edhe 5 punonjës të tjerë “elektricitistë”.

Gjithashtu rezulton se në përgjigje të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues për këtë fakt, KSHA-ja ka arsyetuar se “Dokumenti që kërkohet për punonjës të specializuar/të kualifikuar është një dëshmi profesionale të punonjësve ose ekuivalenti i tij/saj, ofertuesi për disa punonjës ka paraqitur dëshmi kualifikimi për sigurimin teknik. Dokumenti i paraqitur nga ofertuesi “dëshmi kualifikimi për sigurimin teknik” nuk tregon/përfaqëson dëshminë profesionale të punonjësit, konkretisht dëshmia e kualifikimit për sigurimin teknik e z.E.C.”

Lidhur me argumentimin e dhënë nga KSHA-ja, Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shoqërisë “G.A.C” SHPK dhe konstatoi se në të nuk është deklaruar asnjë punonjës me profesionin “elektracist” me inicialet E.C. Punonjësi me inicialet E.C konstatohet se është deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik mbështetës “Shansi Invest” SHPK si vijon:

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet	Punonjës Po [x] Jo []
në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Nëse, po, numri i punonjësve: Prill 2024 – 103 punonjës Sipas dokumentacionit të paraqitur në tender. Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: 1. K A (K R , me profesion Inxhinier, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Inxhinierit Gjeodet, sipas dokumentacionit bashkëlidhur. 2. B Sh , me profesion teknik, i punësuar pranë shoqërisë tonë, në rolin edhe të Teknik Ndërtimi, sipas dokumentacionit bashkëlidhur. 3. D E me profesion teknik, i punësuar pranë shoqërisë tonë, në rolin edhe të Teknik Ndërtimi, sipas dokumentacionit bashkëlidhur. 4. D M , me profesion punonjës, i punësuar pranë shoqërisë tonë, në rolin edhe të Elektracistit, sipas dokumentacionit bashkëlidhur. 5. E K , me profesion punonjës, i punësuar pranë shoqërisë tonë, në rolin edhe të Elektracistit, sipas dokumentacionit bashkëlidhur.

6. D... T..., me profesion punonjës, i punësuar pranë shoqërisë tonë, në rolin edhe të **Elektricitit**, sipas dokumentacionit bashkëlidhur.

7. E... C..., me profesion punonjës, i punësuar pranë shoqërisë tonë, në rolin edhe të **Elektricitit**, sipas dokumentacionit bashkëlidhur.

8. F... A..., me profesion punonjës, i punësuar pranë shoqërisë tonë, në rolin edhe të **Elektricitit**, sipas dokumentacionit bashkëlidhur.

9. E... T..., me profesion punonjës, i punësuar pranë shoqërisë tonë, në rolin edhe të **Elektricitit/teknik elektrik**, sipas dokumentacionit bashkëlidhur.

10. H... K..., me profesion punonjës, i punësuar pranë shoqërisë tonë, në rolin edhe të **Elektricitit**, sipas dokumentacionit bashkëlidhur.

11. P... K..., me profesion punonjës, i punësuar pranë shoqërisë tonë, në rolin edhe të **Elektricitit/teknik elektrik**, sipas dokumentacionit bashkëlidhur.


12. G... K..., me profesion punonjës, i punësuar pranë shoqërisë tonë, në rolin edhe të **Elektricitit**, sipas dokumentacionit bashkëlidhur.

13. F... Sh..., me profesion punonjës, i punësuar pranë shoqërisë tonë, në rolin edhe të **Elektricitit**, sipas dokumentacionit bashkëlidhur.

14. F... T..., me profesion punonjës, i punësuar pranë shoqërisë tonë, në rolin edhe të **Elektricitit**, sipas dokumentacionit bashkëlidhur.

15. M... B..., me profesion punonjës, i punësuar pranë shoqërisë tonë, në rolin edhe të **Elektricitit**, sipas dokumentacionit bashkëlidhur.

16. M... Xh..., me profesion punonjës, i punësuar pranë shoqërisë tonë, në rolin edhe të **Manovrator**, sipas dokumentacionit bashkëlidhur.



Në pikën 1 dhe 4 të nenit 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.” Referuar pikës 4 të nenit 84 të LPP-së, përcaktohet, se autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij dhe në ato raste kur vërtetohet se këto shkaqe ekzistojnë, autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.

Vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor, ka detyrimin që në zhvillimin e procedurave të prokurimit, të zbatojë me përpikëri të gjitha parashikimet ligjore, më qëllim mosdiskriminimin dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

Pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.2.14.2. Përsa i përket arsyes së skualifikimit të shoqërisë “G.A.C” SHPK se “Sipas dokumentave provuese të sjella nga operatori ekonomik “G.A.C” shpk për L. D nuk ka dëshmi kualifikimi për teknik elektroteknik por ka diplomë për Ing.Informatik Ekonomike”, nga verifikimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit rezulton se shoqëria ankimuese ka deklaruar se disponon dy punonjës në rolin Teknik i Lartë Elektroteknik përkatësisht punonjësit me inicialet D.S dhe L.D. Sipas dokumentacionit provues të sjellë në KPP nga autoriteti kontraktor rezulton se për znj. L.D është paraqitur kontratë individuale e punës, e lidhur në datën 10.08.2023 ndërmjet shoqërisë “GAC” SHPK, punëdhënës dhe znj. L.D, punëmarrës ku në nenin 1 të saj është përcaktuar se i punësuar pranë kryejë detyrën e Inxhinier Informatike/sipas nevojave profesionale të punës dhe të shoqërisë, pranë “G.A.C” SHPK; Diplomë “Bachelor në Informatikë Ekonomike”, lëshuar nga Universiteti i Tiranës për znj.L.D si dhe Dëshmi kualifikimi për sigurimin teknik për znj. L.D profesioni “Ing.Infor/Tek.

e lartë inf. Sqarojmë, se kualifikimet e personelit inxhinier i tejkalojnë kërkesat e autoritetit kontraktor.

III.2.14.3. Lidhur me arsyen e skualifikimit të shoqërisë “G.A.C” SHPK se “sipas DST janë kërkuar gjithashtu 3 drejtues mjeti. Operatori ekonomik “G.A.C”shpk nuk ka paraqitur dokumentacion provues për një drejtues mjeti dhe konkretisht për Bajram Alimadhin”, nga verifikimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit rezulton se shoqëria ankimuese ka deklaruar se disponon tre punonjës në rolin Drejtues Mjeti përkatësisht punonjësit me inicialet B.A, A.A dhe K.S. Sipas dokumentacionit provues të sjellë në KPP nga autoriteti kontraktor rezulton se për z. B.A është paraqitur kontratë individuale e punës, e lidhur në datën 01.01.2021 ndërmjet shoqërisë “GAC” SHPK, punëdhënës dhe z. B.A; Librezë pune, letërnjoftimi si dhe pjesa e pasme e lejes së drejtimit të mjetit.

Sa më sipër cituar, në kushtet kur operatori ekonomik ankimues ka dhënë indicie për autoritetin kontraktor, pasi ka paraqitur si dokument provues pjesës e pasme të lejes së drejtimit të mjetit, ky i fundit, referuar nenin 92 pika 1 të *lex specialis* në të cilin përcaktohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.” ka detyrimin procedural që të kryejë verifikimet përkatëse apo të kërkojë sqarime nga ankimuesi, gjë për të cilin rezulton se AK nuk i ka kryer këto verifikime, duke e marrë të mirëqenë që shoqëria ankimuese nuk përmbush kërkesat lidhur me drejtuesin e mjetit me inicialet B.A. Autoritetit kontraktor për një shqyrtim të drejtë dhe objektiv të çështjes, pa cënuar përmbajtjen e ofertës dhe duke mos pasur si qëllim ndikimin në vlefshmërinë e tyre, sa herë lind nevoja për sqarime mbi ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, ka detyrimin ligjor që në mbështetje të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, t’i drejtohet me kërkesë për sqarim operatorëve ekonomikë në përmbushje të qëllimit të *lex specialis* të parashikuar në nenin 2 të tij.

KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me *lex specialis*.

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se përfituesi i drejtpërdrejtë i objektit të prokurimit është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 124 të LPP-së ku përcaktohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi. 2. Për monitorimin e zbatimit të kontratës, autoriteti ose enti kontraktor, nisur nga natyra e objektit të kontratës dhe kohëzgjatja e zbatimit të saj, harton planin e zbatimit të kontratës, duke përfshirë në veçanti çështjet organizative, afatet, çështjet ekonomike e teknike të kontratës së nënshkruar, në

përputhje me çdo akt tjetër ligjor. 3. Plani i zbatimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe operatori ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj. 4. Çdo modifikim i kontratës në përputhje me nenin 127 të këtij ligji, pasqyrohet në planin e zbatimit. 5. Autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me planin, ndjek zbatimin e kontratës, administron dokumentacionin e monitorimit dhe harton raportet e monitorimit. 6. Rregulla të hollësishme për monitorimin e zbatimit të kontratave, sipas tipologjive të tyre, përcaktohen nga rregullat e prokurimit publik. Autoriteti kontraktor duhet të kryejë pagesat në favor të operatorëve ekonomikë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të fushës në fuqi.”

Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, është pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t’u siguruar nëse cilësia e automjeteve të kërkuar në dokumentet e tenderit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit si dhe zhvillimi i të gjithë procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat procedurale që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

Sjellim në vëmendje të autoritetit kontraktor, se është përgjegjësi e këtij të fundit realizimi i procedurës së prokurimit sipas të gjitha hapave procedurale dhe afateve të përcaktuara nga legjislacioni për prokurimin publik, por referuar çështjes në shqyrtim, nisur nga pretendimet e ankimuesit, nuk rezulton që këto veprime apo mosveprime të autoritetit kontraktor të kenë cënuar të drejtat e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës apo të ketë kufizuar të drejtën e ankimit të tij.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 pika 1, 115 pika 1 dhe 3 si dhe neni 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “G.A.C” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-04448-05-13-2024, me objekt: “*Rehabilitimi i ndriçimit të akseve rrugore në qytetin e Durrësit*” me fond limit 24.859.914 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 05.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
 2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën e prokurimit në përputhje me konstatimet e bëra nga KPP në këtë vendim.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “G.A.C” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri